# RAPORT

# I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile:**

- Psiokologji organizative
- Psikologji komunitare

**Ofruar nga Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**


**Prof. Asoc. Dr. Artemisi SHEHU**
**Dr. Valbona TRESKA**


**(Korrik / 2018)**

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Msc në Psikologji me profile:**

- Psikologji organizative
- Psikologji komunitare

| | Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit: | |
|---|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | Urdhër Nr. 401, date 22.07.2016 |
| 4 | Titulli i programit të studimit: | Msc në Psikologji profile:<br>• Psikologi organizative<br>• Psikologji komunitare |
| 5 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 6 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite |
| 7 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 8 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 9 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 10 | Programi ofrohet nga institucioni | Po |
| 11 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | - |
| 12 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 13 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 14 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | 7 |
| 15 | Aktivizimi i programit të studimit | 2016 - 2017 |
| 16 | Numri i studentëve për këtë program studimi | 31 |

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

**HYRJE**

**Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në "Psikologji" me profile: "Psikologji organizative; "Psikologji komunitare"**

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka filluar aktivitetin e tij me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.177 dt.19.02.2009 si "*Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë*", "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" është akredituar institucionalisht me Urdhër Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në vendimin Nr.303 dt 13.01.2012.
Me Urdhër të Ministrit Nr 273 dt 18.05.2017, hapet njësia kryesore " Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike" të Shkollës së Lartë Private" Mesdhetare e Shqipërisë" me strukturën e mëposhtme:

a) Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë;
b) Departamenti i Shkencave Politike;
c) Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë

Me Urdhër të Ministrit Nr. 278 dt. 19.05.2017, "*MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT "MESDHETAR I SHQIPËRISË"* institucioni funksionon si Universitet. Që nga ky moment universiteti është i përbërë nga tre fakultete.
Ky program studimi është licensuar me Urdhër Nr. 401, datë 22.07.2016, si "Master i Shkencave në "Psikologji", me profile: "Psikologji organizative" dhe "Psikologji komunitare" në Fakultetin e Shkencave Juridike dhe Politike, të Shkollës së Lartë Private Mesdhetare të Shqipërisë, që realizohet me 120 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 2 vite akademike / 4 semestra, në gjuhën shqipe.
Me Vendim Senati Nr. 6/1, datë 19.05.2017 institucioni miraton organizimin e programeve të studimit nga njësitë përgjegjëse në përputhje me strukturën e miratuar.
Sipas këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike si dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë organizon edhe programin e studimit Msc në Psikologji me profile: Psikologji organizative dhe Psikologji komunitare që është në proces akreditimi.

Raporti i vlerësimit të jashtëm, mbështetet në shqyrtimin e dokumentave të mëposhtme si:

- Shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të UMSH, në të cilën organizohet e gjithë veprimtaria e zhvillimit të programeve mësimore (rregullore dhe udhëzime, vendime, dosjet e programeve të studimit, regjistrat themeltar, dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore, sekretaria mësimore).
- Vëzhgimet e kryera gjatë vizitës dy ditore në vend si dhe në intervistimet me studentët, stafin akademik efektiv dhe me kontratë, stafin administrativ ndihmës, takimet me drejtuesit e institucionit si dhe vizitat në zyrën e burimeve njerëzore, zyrën e NJSBC, zyrën e kurrikulave, bibliotekë, laborator, etj.

---

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

☑ Përbërja e GVJ:

1. **Prof As Artemisi SHEHU**
2. **Dr. Valbona TRESKA**

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda DEMIRNELI.

Më datë 09.07.2018 përmes sistemit Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, UMSH përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës nr. 1103 prot, datë 13.07.2018 Objeksione për Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Msc në Psikologji me dy profile: Psikologji organizative dhe Psikologji komunitare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi shqyrtoi me kujdes komentet ndaj draft raportit vendosi të mos bëj ndryshime në këtë draft raport. Ky draft mer formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka filluar aktivitetin me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.177 dt.19.02.2009 si "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë". "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" është akredituar institucionalisht me Urdhër Nr. 124 dt. 29.03.2012 mbështetur në vendimin Nr.303 dt 13.01.2012.
Ky program studimi është licensuar me Urdhër Nr. 401, datë 22.07.2016, si "Master i Shkencave në "Psikologji", me profile: "Psikologji organizative" dhe "Psikologji komunitare"
Me Urdhrër Nr. 273, date 18.05.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është miratuar hapja e njësisë kryesore "Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike" dhe riorganizimi i njësisë kryesore nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në "Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare" të Shkollës së lartë private "Mesdhetare e Shqiperise"
Hapja e njësisë së re kryesore Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, solli riorganizim dhe të njësive bazë me strukturën si më poshtë:

- Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë;
- Departamenti i Shkencave Politike;
- Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë;

Riorganizimi i Njesisë Kryesore nga "Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike" në "Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare" solli ndryshim dhe të strukturës së kësaj njësie si më poshtë:

- Departamenti i të Drejtës Publike;
- Departamenti i të Drejtës Civile;
- Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare;

Me Urdhër të Ministrit Nr 278 dt 19.05.2017, "*MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT "MESDHETAR I SHQIPËRISË"*, miratohet statuti e ri, në të cilin janë pasqyruar dhe ndryshimet përkatese mbi organizimin institucional të organeve drejtuese të administrimit dhe ato akademike si dhe çeshtje te tjera të lidhura me mësimdhënien dhe mesimnxënien, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile: Psikologji organizative dhe Psikologji komunitare ka si qëllim plotësimin e nevojave për informacion jo vetëm në fushat e sipërpërmendura, por edhe të disa fushave të tjera ekstra si mikrokreditimi, të drejtat e njeriut, provomovimi individual dhe bashkëveprimi global, çështje juridike dhe ekonomike, apo edhe në aspekte të tjera që lidhen me dixhitalizimmin e jetës në kontekstin e kohës së sotme.
Një psikolog organizacional mund të jetë i aftë përmes këtij programi të punojë në çështjet organizative që lidhen me stresin në mjedisin e punës, shterrjen profesionale, motivimin në punë, rritjen e aftësive të stafit, mangësitë në orientim ose dështimet në përshtatje me grupin social apo kulturor të cilit i përket. Puna me grupet e ndryshme në ndërmarrje apo qendra pune me prejardhje të

ndryshme kulturore e socialekonomike do të ishte edhe fokusi i aftësimit të këtyre kuadreve të ardhshëm. Nga ana tjetër, misioni i përgatitjes së psikologëve komunitarë do të përqendrohet në njohjen, parandalimin e problematikave sociale, promovimin e ndryshimit në shoqëri, etj. Një vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe çështjeve të rehabilitimit psikosocial.
Ky master organizohet në gjuhën shqipe, me një kohëzgjatje 2 vjeçare.
Sipas rregullores së këtij programi objektivat e tij janë: përgatitja e ekspertëve dhe specialistëve në përgjithësi në fushën e psikologjisë, formimi teorik dhe praktik i studentëve në fushat organizicionale dhe komunitare, thellimi i njohurive shkencore në fushën e psikologjisë organizative dhe komunitare.
Edhe kërkimit shkencor i është munduar t'i lihet një vend i rëndësishëm në përpjekje për të thelluar teknikat cilësore të kërkimit shkencor.
Disa lëndë si "Zhvillimi me Mikrokreditë dhe Kultura pop", "Komunikimi dixhital dhe globalizimi" janë përpjekur për t'i ndihmuar edhe më tepër studentët të futen në aktivizimin më të plotë të shtresave në nevojë të shoqërisë, dhe për t'i aftësuar ato të bëhen më të mundura për të zhvilluar fuqitë e tyre. Duke parë disnivelet e mëdha social-ekonomike të shoqërisë sot, aftësimi i shtresave në nevojë do të ishte një aspekt pozitiv dhe nga ana tjetër zhvillimet teknologjike të komunikimit sot do të vendosnin dixhitalizimin në stade domosdoshmërie.
Sipas Statutit të UMSH, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është një institucion që ka për vizion të ofrojë vlera qytetarie dhe profesionalizmi përmes një edukimi ndërdisiplinor, në një mjedis social dhe aktiv dhe në përputhje me interesat kombëtare. Misioni i këtij institucioni janë: ofrimi i studimeve në fushat juridike, ekonomike, psikologjike, sociale, politike, marrëdhënieve ndërkombëtare; zhvillimin dhe ruajtjen e dijeve përmes mësimdhënies, formimin e studiuesve të rinj në fushat përkatëse, thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të fushës, të kontribojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave kombëtare të vendit.
Qëllimet e UMSH janë disa: ofrimi i studimeve universitare në cikle të ndryshme studimore, ofrimi i studimeve afatshkurtra, kualifikime e specializime, të lidhë marrëveshje bashkëpunimi e ekspertize me ente e institucione të ndryshme publike e private. Strategjia e UMSH është në përputhje me interesat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe ky institucion po punon për ta realizuar këtë strategji edhe përmes programeve të studimit që ofron. Nga shqyrtimi i statutit dhe rregullores së programit të studimit Msc në Psikologji me profile vihet re përputhshmëri, por objektivat specifikë për secilin prej profileve duhet të jenë të organizuara më specifikisht në rregullore.

## Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve[1] |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;<br><br>**Kriteri 4** Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; | Programi i studimit Master i shkencave në Psikologji me profile është një master që në përgjithësi ka përputhje me vizionin, misionin e qëllimet e institucionit të arsimit të lartë UMSH. Bazuar te statuti dhe rregullorja e këtij institucioni ku janë të specifikuara këto misione |
| **Kriteri 5** Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;<br><br>**Kriteri 6** Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. | dhe objektiva vihet re se dy rrugët kryesore esenciale të zhvillimit strategjik të tij janë:<br>• zgjerimi demografik<br>• rritja e cilësisë në mësimdhënie.<br>Dukshëm ky master synon të vazhdojë rrjedhën e këtij misioni të UMSH. Misioni i këtij institucioni synon në disa drejtime si: ofrimi i studimeve në fushat juridike, ekonomike, psikologjike, sociale, politike, marrëdhënieve |

[1] GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

| | |
|---|---|
| | ndërkombëtare; zhvillimin dhe ruajtjen e dijeve përmes mësimdhënies, formimin e studiuesve të rinj në fushat përkatëse, thellimin e kualifikimit professional e shkencor të specialistit të fushës, të kontribojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave kombëtare të vendit.<br>Ndërkohë që edhe objektivat e institucionit lidhen me këto qëllime si: ofrimi i studimeve universitare në cikle të ndryshme studimore, ofrimi i studimeve afatshkurtra, kualifikime e specializime, të lidhë marrëveshje bashkëpunimi e ekspertize me ente e institucione të ndryshme publike e private.<br>Programi i studimit Master i shkencave në Psikologji synon të përgatitë studentë profesionistë në fushën organizative dhe atë komunitare.<br>*Në rregulloren e këtij programi studimi nevojitet të specifikohen më mirë misioni, qëllimi dhe objektivat e këtij program studimi, pra të paraqiten thelbësisht misioni i programit dhe vizioni i programit.*<br>Parimisht mbeten të jenë në përputhje me misionin madhor të UMSH, por nevojitet specifikim në rregullore.<br>Institucioni ka tentuar të bëjë dhe një analizë dhe vlerësim të tregut të punës, por studimi është departamental i pergjithshëm dhe jo i specifikuar vetëm për këtë master me këto dy profile specifikisht. Gjithësesi, tregu shqiptar i psikologëve ka vështirësi të mëdha në pozicionimin e ekspertëve organizacionalë dhe komunitarë për shkak të një sërë problematikash që kërkojnë kohë të zgjidhen: si licensimi i psikologut, përfshirja e psikologut në stafet e punonjësve dhe kërkimi, vlerësimi e supervizimi i cilësisë së ushtrimit të punës së tyre. Pra, gjurmimi i boshllëqeve të punonjësve psikologë organizacionalë dhe komunitarë në një kohë kur tregu është një një kaos të konsiderueshëm profesional të psikologut dhe në përpjekje për t'u rregulluar nga UP (Urdhri i Psikologut), mbetet mjaft i vështirë. |
| | Programi i studimit Master i shkencave në Psikologji synon të përgatitë specialist organizacionalë dhe komunitarë me aftësi:<br>- Në njohjen e problematikave me karakter klinik, etik këshillimi, njohjen e termave në fushat social-psikologjike, në teknikat cilësore të kërkimit dhe analizë komunikimi, me aftësi në ngritjen e fuqizimit të shtresave në nevojë përmes marrjes së mikrokredive, me njohuri teorike në psikologjinë ndërpersonale; |

| | |
|---|---|
| | - Më specifikisht, psikologë organizacionalë me aftësi në: zhvillimin e tregut, dinamikat e grupit social dhe menaxhimit të diferencave brenda tij, menaxhimit të burimeve njerëzore e këshillimit të karrierës, testimit dhe vlerësimit në organizata, me tregun e lirë dhe marketingun social, si dhe me komunikimin në marrëdhëniet me publikun dhe komunikimin dixhital;<br>- Më specifikisht psikologë komunitarë me aftësi në: njohjen e psikopatologjisë së zhvillimit, ndërhyrje në kriza, në psikologji klinike të devijancave, me njohuri të psikologjisë së shëndetit, me njohjen e shtresave sociale të shoqërisë dhe problematikave të tyre, njohuri mbi shtetin ligjor dhe mënyrën si funksionon shoqëria dhe njeriu në të,<br>- Si dhe me njohje të profesionit të psikologut organizacional e komunitar në terren përmes praktikës së kurrikulës.<br>- Përpiqet të kombinojë formimin teorik me aftësitë aplikative përmes praktikës;<br>Aftësi kërkimore në metoda cilësore të kërkimit shkencor. Ky program jep njohuri të gjera dhe të përgjthshme kryesisht, ndërshkencore (psikologji, sociologji, ekonomike, juridik, politikë, dhe kërkim shkencor) studentëve ndjekës të tij, dhe i jep mundësinë të njohin fenomene të fushës organizacionale dhe komunitare në përpjekje për të vazhduar edhe më tej studimet doktorale.<br>Pozicionet e psikologut organizacional dhe atij komunitar janë të vështira të pozicionohen në tregun tonë të punës në shoqërinë shqiptare, pasi janë të reja dhe studimi i gjetjes së punësimit dhe vazhdimësia e tij mbeten një studim i të ardhmes. Aktualisht, prodhimin më të madh të psikologëve organizacionalë e mban UT (Universiteti i Tiranës) dhe studentët e prodhuar hasin vështirësi në gjetjen e një pune në profesion. |
| | Ndërkohë që psikologu komunitar është një degë tërësisht e re për tregun tonë dhe duhet pozicionuar mirë vendi i tij i punës dhe gjetja e një punësimi të përshtatshëm.<br>*Departamenti është përpjekur të prezantojë një vlerësim të tregut të punës, por për këta dy profile mungojnë të dhënat reale që i korrespondojnë studentëve të diplomuar deri më sot në treg dhe nevojës së qendrave, institucioneve publike dhe jo publike për këta profesionistë. Mbetet një vështirësi për të* |

| | |
|---|---|
| | *njohur konkretisht nevojën dhe kërkesën e tregut.* Është bërë përpjekje për të përshtatur në kurrikul programet e disa universiteteve të huaja perëndimore, dhe kurrikula e këtij masteri shkencor paraqitet e përgjithshme në njohuri për studentin që duhet të profilizohet në drejtimin organizacional dhe atë komunitar. Në analizën e nevojave të tregut për hapjen e programeve thuhet të jenë marrë në konsideratë disa të dhëna si: numri i studentëve në psikologji të regjistruar ndër vite, dhe aktualisht thuhet në RVB, të dhënat nga INSTAT-i, të dhënat nga zyra e punësimit të rekomanduara nga praktikat e punës së studentëve; të dhënat nga MAS, nga vjetori statistikor i arsimit; programet e ofruara të IAL-së, etj, por *këto të dhëna nuk shihen të jenë të pasqyruara në dokumentin e tregut të punës*. Në këtë analizë janë të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar në IAL publike e private, numrin e studentëve në parashikueshmërinë institucionale UMSH deri në vitin 2020, dhe mbi numrin e parashikueshëm në sektorët e ndryshëm për punësim deri në 2020-ën, por jo të tjera të dhëna. Kjo vështirëson konkludimet mbi punësimin e ardhshëm të këtyre studentëve. Gjithashtu, në raportin e vlerësimit të brendshëm thuhet se: "kemi promovuar formimin profilizues të studenteve; dhe në rastin konkret të pergatise aspirante te rinj te specializuar ne fushe e psikologjise organizative dhe komunitare qe do te jene te afte dhe do te kene kapacitet e nevojshme qe te hyne ne tregun e punes ne te gjitha ato hapesira institucionale, administrative publike apo private si edhe te sipermarrjes si nje gjenerate qe manifeston gatishmerine per t'u perballuar me sfidat dhe per te zgjidhur problemet qe jane tashme sfida te konteksitit dhe shoqerise shqiptare". *Por konkretisht, këta specialist nuk janë provuar ku të punojnë. Dhe tregu i punës është ende i paeksplouar siç duhet.* |
| | Gjithsesi është bërë një përpjekje për ta vlerësuar tregun e punës. Nevojat ekonomike të vendit sigurisht që mbështesin edhe hapjen e këtij programi në Msc psikologji me profile organizacional e atë me profil komunitar. Universiteti është përpjekur të respektojë politikat e promovuara nga Bashkimi Evropian në kuadrin e integrimit europian dhe interest e zhvillimit të arsimit në vendin tonë dhe rajon. Këto programe studimi i kushtojnë gjithashtu një vëmendje të veçantë edhe studimeve |

| | |
|---|---|
| | antropologjike dhe kulturore që lidhen me identitetin historik të vendit tonë. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; | Nga vlerësimi i dokumentacionit, statutit, rregullores së institucionit dhe asaj të programit vihet re se UMSH është një institucion me mision dhe objektiva te përcaktuara në fushën e arsimit në vend. Misioni i këtij institucioni synon në: ofrimi i studimeve në fushat juridike, ekonomike, psikologjike, sociale, politike, marrëdhënieve ndërkombëtare; zhvillimin dhe ruajtjen e dijeve përmes mësimdhënies, formimin e studiuesve të rinj në fushat përkatëse, thellimin e kualifikimit professional e shkencor të specialistit të fushës, të kontribojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave kombëtare të vendit.<br>Ndërkohë që qëllimet e UMSH janë disa: ofrimi i studimeve universitare në cikle të ndryshme studimore, ofrimi i studimeve afatshkurtra, kualifikime e specializime, të lidhë marrëveshje bashkëpunimi e ekspertize me ente e institucione të ndryshme publike e private. Strategjia e UMSH është në përputhje me interesat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe ky institucion po punon për ta realizuar këtë strategji edhe përmes ketij programi studimi. |
| **Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;<br><br>**Kriteri 2** Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. | Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, si rregullorja e programit dhe kurrikula e programit vihet re se Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile: funksionon mbi bazën e rregullores së tij të studimit, e cila mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, date 22.07.2015, Statutin dhe Rregulloren Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Kështu, vihet re se, veprimtaritë formuese të programit janë të formimit të përgjithshëm dhe të formimit karakterizues (gjithsej 85 ECTS), praktikë profesionale (15 ECTS) dhe Teze diplome (20 ECTS). Format kryesore të punës mësimore janë leksionet, seminaret; praktikat mësimore, detyrat e projektet dhe provimet. |

| | |
|---|---|
| | Lëndët vlerësohen me ECTS (kredite) sipas raportit, 1/25 (1 ECTS kredit është i barazvlefshëm me 25 orë pune mësimore dhe individuale të studentit). Përcaktimi i ECTS bëhet nga departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë dhe miratohet nga Dekani. Programi Master i Shkencave në Psikologji me profile është pjesë perbërëse e studimeve të ciklit të dytë në strukturën akademike të Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike te Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare te Kualifikimeve, ky program ka një kohezgjatje prej 2 vitesh akademike dhe ndahet në katër semestra, në perfundim të të cilave studenti përfiton 120 ECTS kredite gjithsej. Ky program studimi mund të ndiqet nga studentë të universiteteve shqiptare (publike e private) dhe nga vende te jera shqipfolëse, të cilët kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe zotërojnë së paku diplomën universitare 'Bachelor' dhe kanë grumbulluar 180 ECTS ne studimet e ciklit paraardhës. |
| **Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. | Nga takimet me dekanin e fakultetit të shencave sociale, psikologjike dhe politike, si dhe përfaqësues të departamentit, si dhe shqyrtimit të statutit dhe rregullores së universitetit, vihet re se institucioni ka një plan strategjik të kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Ky plan ka disa pika:<br>• Krijimi i një prespektive institucionale për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, dedektimit te prioriteteve, thellimit dhe forcimit te kerkimit shkencor dhe bashkëpunimit,<br>• Krijimi i një baze të qëndrueshme finaciare,<br>• Krijimi i nje atmosfere te duhur per kerkimin shkencor dhe rritjen e potencialit te stafit,<br>• Rritja e nivelit të bashkëpunimit me grupet e interesit dhe sektorin publik e privat<br>• Rritja e debatit shkencor në shkallë universiteti, kombëtar dhe ndërkombëtar<br>• Nxitja dhe rritja e vëllimit të botimeve dhe rritja e kapaciteteve të bibliotekës<br>• Rishikimi i rregullit dhe ripunimi i Strategjisë së zhvillimit institucional, kërkimit |

| | |
|---|---|
| | shkencor dhe bashkëpunimit për të garantuar efikasitetin e saj.<br>Plani strategjik i zhvillimit të UMSH parashtron një program bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar në fushat me interes reciprok me partnerë vendas dhe të huaj. Disa nga objektivat e planit të bashkëpunimit si në fushën mësimore ashtu edhe në atë kërkimore shkencore si dhe arritje konkrete janë:<br>• Rritja e nivelit të mësimdhënies.<br>Per arritjen e këtij objektivi Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë ka bashkëpunuar me institucione dhe pedagogë të specializuar në fusha te veçanta, si rezultat i të cilit jane ftuar lektorë nga universitete te ndryshme. Bashkëpunimi është bërë me Universitetin e Tiranës, me Universitetin Sigmund Freud në Paris, me Universitetin e Anglisë Lindore, me Universitetin Italisë, nga ana tjetër, pedagogë të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë japin mësim në institucione homologe të arsimit të lartë në vend dhe rajon.<br>• Rritja e nivelit shkencor të vet pedagogëve<br>Për këtë institucioni, së bashku me shumë institucione analoge në rajon, ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me pjesëmarrjen e specialistëve të ndryshëm në të gjitha fushat me interes të përbashkët, gjithashtu edhe nga bashkëbisedimet me drejtuesit e mësimdhënësit e programit, institucioni mbeshtet personelin e vet akademik për realizimin e studimeve doktorale dhe marrjen e gradave shkencore në universitete brenda dhe jashtë vendit. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile prezantohet përgjithësisht në përputhje me, misionin, qëllimet dhe objektivat e Institucionit që, paraqiten në planin strategjik të institucionit.

Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile paraqitet i integruar me strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë ka nje plan strategjik të zhvillimit i cili parashtron një program

për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar.

**Standardet për këtë rubrikë janë plotësuar plotësisht.** *Por sugjerimet për këtë rubrikë konsistojnë në faktin që:*

1. *Në rregulloren e programit të studimit master i shkencave në Psikologji me profile të qartësohen dhe specifikohen në nene të veçanta misioni dhe qëllimi i këtij programi. Aty gjenden vetëm objektivat e programit.*
2. *Në rregulloren e programit të studimit master i shkencave në Psikologji me profile të qartësohen në nene të veçanta qëllimet e ndara dhe specifike për çdo profil studimi: specifikisht për profilin Psikolog Organizativ dhe specifikisht për me profilin Psikolog Komunitar.*

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura organizative e UMSH është e përcaktuar në Statutin e tij, në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Struktura akademike përgjegjëse për progamin e studimit Msc në Psikologji me profile, është Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, i cili synon të përgatisë psikologë, sociologë, politologë, dhe specialistë të administratës publike.

Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ka në përbërje tre departamente që funksionojnë si njësi bazë:

1. Departamenti i Psikologjise dhe Sociologjisë
2. Departamenti i Shkencave Politike
3. Departamenti i Administrimit Publik dhe i Formimit Bazë

që synon të përgatisë specialistë në fushën e Studimeve Psikosociale dhe të Psikologjisë me profil Psikologji Organizative dhe Psikologji Komunitare dhe të promovojë kërkimin shkencor në këtë drejtim.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

☑ **Struktura akademike e Fakultetit**

Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike përbëhet nga tre Departamente dhe për vitin akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij;

**Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë** ka gjithsej **16** pedagogë, nga të cilët **9** janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku **6** me tituj/grada, kurse **7** pedagogë janë personel akademik me kontratë (PAK) nga ku **5** me tituj/grada.

**Departamenti i Shkencave Politike** ka gjithsej **11** pedagogë, nga të cilët **8** janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku **6** me tituj/grada, dhe **3** personel akademik me kontratë(PAK) nga ku **1** me tituj/grada.

**Departamenti i Administrimit Publik dhe i Formimit Bazë** ka gjithsej **7** pedagogë nga të cilët **7** janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku **3** me tituj/grada, dhe **0** personel akademik me kontratë (PAK).

Në total Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike përbëhet nga **34 pedagogë**.

Nga RVB dhe takimet në institucion mësohet se përbërja e këtij fakulteti është: Dekan i këtij Fakulteti është Prof. Asoc. Dr Përparim Kabo, përgjegjësja e departamentit të psikologjisë dhe sociologjisë është PhD. Inis Shkreli. Departamenti ka në përbërjen e tij lektorët për grupin e lëndëve të shkencave sociale PhD. Arjeta Veshi, PhD. Ilda Kashami dhe PhD. Mihal Zoto kandidat, për grupin e lëndëve të shkencave të psikologjisë klinike PhD. Mimoza Ahmetin dhe PhD. Manjola Çollaku kandidate, dhe për grupin e lëndëve Shkenca Psikologji organizative dhe komunitare Dr. Klodjana Rafti dhe doktorante Ela Tollkuçi.

☑ **-Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat**

Nga takimet me përgjegjësin e departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë si dhe anëtarët efektivë përbërës të tij nuk u vu re ndonjë ndryshim mbi të dhënat e deklaruara nga Institucioni në raportin e Vlerësimit të brendshëm mbi këta tregues. Të dhënat e stafit akademik efektiv dhe me kontratë ishin të përputhura me ato të dokumentacionit të vënë në dispozicion. Për këtë pikë referojuni edhe tabelave 1 dhe 2 te Anekset.

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni ka së paku dy Fakultete;<br><br>**Kriteri 3** Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;<br><br>**Kriteri 4** Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;<br><br>**Kriteri 5** Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor". | Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UMSH dhe nga dokumentet e konsultuara u vu re se ky institucion synon çuarjen përpara te zhvillimit e kërkimit shkencor, rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjen e konkurrencës mes stafit të tij dhe përfshirjes së tyre në tregun rajonal e më gjerë due përfshirë edhe studentët në këtë proces. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë synon përmes takimeve dhe bashkëpunimeve të zhvillojë edhe më tej kërkimin shkencor si dhe debatin shkencor në fusha të ndryshme studimore.<br><br>Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka aktualisht tre njesi kryesore:<br>**1.** Fakulteti i Shkencave Ekonomike;<br>**2.** Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;<br>**3.** Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike<br>Nga dokumentet e shqyrtuara, rregulloret e statutin e universitetit, Fakultetet përbërëse organizohen në tre Departamente nga më shumë se tre programe studimi, konkretisht:<br><br>**Fakulteti i Shkencave Ekonomike përbëhet;**<br>**1.** Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet<br>**2.** Departamenti i Ekonomisë<br>**3.** Departamenti i Informatikës dhe i Formimit |

| | |
|---|---|
| | Shkencor.<br>Në përberje të këtyre departamenteve gjenden 13 programe studimi.<br>**Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombetare përbëhet;**<br>**1.** Departamenti i të Drejtës Publike;<br>**2.** Departamenti i të Drejtës Civile;<br>**3.** Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.<br>Në përbërje të këtyre departamenteve gjenden 7 programe studimi.<br>**Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale, dhe Politike përbëhet;**<br>**1.** Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë;<br>**2.** Departamenti i Shkencave Politike;<br>**3.** Departamenti i Administratës Publike dhe i Formimit Bazë.<br>Në përbërje të këtyre departamenteve gjenden 8 programe studimi. |
| | Në Departamentin e Psikologjisë dhe Sociologjisë, gjenden dy programe studimi: Bachelor në Studime Psikosociale dhe Master i Shkencave në Psikologji me profil: Psikologji Organizative dhe Psikologji Komunitare.<br><br>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile ka si mision:<br>• Të promovojë kërkimin shkencor dhe ushtrimin e profesionit të psikologut këshillimor duke promovuar formimin e këshilluesve të mirëfilltë në fushën e veprimit të Psikologjisë organizative dhe Psikologjisë komunitare. Ky program relizohet përmes këtyre objektivave formues.<br>• Pajisjen e studentëve me një formim sa më bashkëkohor në psikologji.<br>• Përvetësimin e kulturës së këshillimit psikologjik me orientim organizativ dhe komunitar si dhe pasjisjen me instrumentet themelore nevojshëm për të përditësuar aftësitë e tyre.<br>• Thellimin e njohurive, sidomos në aspektin diagnostikues, vlerësues dhe këshillimor dhe trajtues si edhe organizimin e aktiviteteve plotësuese. |
| | • Zhvillimin e kapaciteve klinike dhe këshillimore, të empatizimit me nevojat e individit dhe etikës profesionale, respektimit të të drejtave të njeriut.<br>• Të mbajturin ne konsiderate të nevojave të tërësisë së komuniteteve, insitucioneve në shoqëri, bizneseve, aktualiteteve të zhvillimit teknologjik si edhe të komunikimit në mirëqenien e individit në jetën e përditshme.<br><br>Të gjitha këto objektiva studimorë duken të gjerë dhe shumë ambiciozë për t'u realizuar në një program studimi |

| | |
|---|---|
| | me profile në Psikologji organizacionale dhe Psikologji komunitare.<br><br>*Disa prej këtyre objektivave i përkasin një psikologu klinik siç është objektivi nr 3 me këtë përmbajtje*: Thellimin e njohurive, sidomos në aspektin diagnostikues, vlerësues dhe këshillimor dhe trajtues si edhe organizimin e aktiviteteve plotësuese.<br><br>*Psikologu organizacional dhe ai komunitar nuk mund të merren me diagnostikim, vlerësim, këshillim dhe trajtim pasi në këtë mënyrë ndërhyjnë në punën dhe profilin e një tjetër psikologu, pikërisht atij klinik.*<br><br>Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë përbëhet aktualisht, për vitin akademik 2017-2018 nga **9** anëtarë efektiv (PAE), nga të cilët **1** është me gradë Prof. Asoc. Dr dhe **5** anetarë kane gradën "Doktor". |
| **Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. | Gjatë vizitës në Institucion nga biseda me dekanin, përgjegjësin e Departamentit, zyrën e burimeve njerëzore dhe informacionet e marra nga dokumentacioni vihet re se nisur edhe nga përgjegjësia për realizimin me sukses të programeve të studimit, zyra e burimeve njerëzore përcakton, para fillimit të çdo viti akademik, kërkesat për personel akademik me kohë të plotë ose të pjesshme bazuar në nevojat që paraqet departamentit i cili ka vlerësuar nevojat e tij për vitin akademik. Kërkesa për rekrutimin e stafit akademik pasi miratohet nga Dekani dhe Rektori, publikohet në faqen zyrtare të UMSH në median elektronike dhe atë të shkruar.<br><br>Nga statuti i UMSH, takimet e realizuara dhe nga RVB u vlerësua se për të realizuar procedurën e rekrutimit të personelit, Rektori ngre komision të kryesuar nga Dekani i fakultetit si dhe përfaqësues nga departamenti i shkencave psikologjike, sociale e politike si dhe përgjegjësist e departamenteve dhe personel akademik bazë, të cilët vlerësojnë CV e grumbulluara të kandidatëve. Kandidati duhet të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin pranë |
| | zyrës së BNJ të UMSH, kjo e fundit i përcjell komisionit të ngritur. Komisioni merr në intervistë kandidatët e seleksionuar. Komisioni harton raportin mbi procesin dhe këtë të fundit ia dërgon në formë propozimi për miratim Rektorit pas vendimmarrjes përfundimtare. Përzgjedhja e personelit realizohet në përputhje me kriteret e parashikuara në Statutin e UMSH dhe rregulloren e tij. Pas miratimit nga Rektori, realizohet edhe nënshkrimi i kontratës së kandidatit fitues. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Si përfundim mund të themi se, institucioni është organizuar në tre njësi kryesore, të cilat organizohen në tre Departamente të përbërë nga disa programe studimi. Më konkretisht, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike përbëhet nga programe studimi që kanë misione dhe objektiva në përputhje me misionin dhe qëllimin e universitetit. Departamenti në bashkëpunim me njësitë kryesore bashkëpunon për të realizuar me sukses realizimin e programeve të studimit. Vihen re pika të forta si organizimi i mirë i fakulteteve të UMSH, ndarja e detyrave të secilit dhe faktit që çdo fakultet udhëhiqet nga objektiva në përputhje me misionin dhe qëllimet e UMSH të përcaktuara në statut; si dhe procedura e rekrutimit të stafit dhe respektimi i saj në përzgjedhjen e personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë.

Objektivat e programit të studimit Master në Psikologji me profil Psikologji organizative dhe Psikologji komunitare janë në përputhje me misionin e UMSH, *por sugjerohet që objektivi i tretë sipas RVB pikërisht ''Thellimin e njohurive, sidomos në aspektin diagnostikues, vlerësues dhe këshillimor dhe trajtues si edhe organizimin e aktiviteteve plotësuese'', të rishikohet, ridimensionohet apo edhe eleminohet, pasi psikologu organizacional dhe ai komunitar nuk mund të merren me diagnostikim, vlerësim, këshillim dhe trajtim, pasi në këtë mënyrë ndërhyjnë në punën dhe profilin e një tjetër psikologu, pikërisht atij klinik.*

Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë përbëhet aktualisht nga **9** anëtarë efektivë (PAE), nga të cilët **6** me tituj/grada.

**Standardet për këtë rubrikë janë plotësuar kryesisht.**

*Sugjerohet rishikimi, ridimensionimi apo edhe eleminimi i objektivit të tretë të studimit ''Thellimin e njohurive, sidomos në aspektin diagnostikues, vlerësues dhe këshillimor dhe trajtues si edhe organizimin e aktiviteteve plotësuese'', pasi psikologu organizacional dhe ai komunitar nuk mund të merren me diagnostikim, vlerësim, këshillim dhe trajtim, pasi në këtë mënyrë ndërhyjnë në punën dhe profilin e një tjetër psikologu, pikërisht atij klinik.*

## 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë sipas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, ndahet në tre kategori:

- Personel Akademik;
- Personel ndihmës mësimor-shkencor
- Personel administrativ.

Personeli akademik është efektiv dhe me kontratë. Personeli akademik kryen mësimdhënie dhe lektrim, udhëheqje detyrash dhe diplome, punë kërkimore shkencore.

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi për dy vite akademike është:

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **10** pedagogë gjithsej, nga te cilet **7** kanë qenë PAE nga këta: **2** janë Prof.As, **4** Dr, dhe **1** Dr në proc, dhe **3** PAK, nga këta: **1** Prof.As, **2** Dr. Pra raporti PAE/PAK është **70%/30%.**

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **12** pedagogë gjithsej, nga te cilet **10** janë PAE nga këta: **2** janë Prof.As, **8** Dr, dhe **2** PAK, të **2** Dr. Pra raporti PAE/PAK është **83%/17%.**
Personeli adminstrativ e mbështetës ka qenë 7 për vitin 2016-2017 dhe 8 për vitin 2017-2018. Ngarkesa mësimore është e përballuar kryesisht nga personel i brendshëm efektiv, më konkretisht për vitin e parë akademik 2016-2017 personeli i brendshëm efektiv mban ngarkesën prej 7 lëndësh që e mbulon dhe personeli i ftuar mban ngarkesën prej 3 lëndësh.
Vihet re se stafi i brendshëm **mbulon 70% të ngarkesës mësimore** dhe stafi i ftuar **30% të ngarkesës**.
Ndërkohë, për vitin e dytë akademik 2017-2018 stafi i brendshëm vlerësohet të mbulojë 10 lëndë dhe pedagogë të ftuar 3 lëndë. Vihet re se stafi i brendshëm **mbulon 83% të ngarkesës mësimore** dhe **17% e mbulon ai i ftuar**. Vihet re se shumica e personelit akademik kanë pasur 1 lëndë si ngarkesë mësimore në semestër për këtë program dhe 2-3 pedagogë efektivë kanë pasur 2 lëndë si ngarkesë mësimore vjetore për këtë master.
Personeli akademik efektiv apo ai me kontratë rekrutohet në fillim viti akademik sipas nevojës së ddepartamentit duke ndjekur rregulloren, statutin dhe bashkëpunuar me zyrën e Burimeve Njerëzore.

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program per vitin akademik aktual është 12/13, ndërsa për vitin akademik 2016-2017 është 10/15

Raporti PAE/PAK në këtë program për vitin akademik aktual është 10/2, ndërsa per vitin akademik 2016-2017 është 7/3

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ **Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat ne aneks)**

Për vitin akademik 2016-2017 nga departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë janë vetëm 4 pedagogë efektivë dhe 3 të tjerë efektivë janë nga departamentet e tjera të UMSH po të brendshëm.
Për vitin akademik 2017-2018 nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë janë 6 pedagogë efektivë që mbulojnë ngarkesat për vitin e parë dhe të dytë të masterit dhe 3 pedagogë efektivë janë nga departamentet e tjera të UMSH. Për më tepër referoju edhe tabelave Nr 4 te Anekset.

☑ **Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit**

Këshillimi shkencor i programit të studimit është i përbërë nga këto emra:

1. Prof. Asoc. Nevila Rama. (Koordinatori i programit)
2. Prof.As Nevila Xhindi,
3. Prof.As Përparim Kabo
4. Prof.As Shefqet Muçi

Për më tepër referoju edhe tabelës Nr 3 te Anekset.

☑ **Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre**

Kualifikimi i stafit mësimor për këtë Master është me tituj e grada shkencore. Për vitin akademik 2016-2017 situata e stafit akademik mësimor ka qenë kryesisht e mbuluar nga staf i kualifikuar, të

cilit nuk përkonin shumë me profilin e programit për shkak të edukimit bachelor dhe master të tij: ekonomik (Altin Hoti, Nikollaq Pano) apo juridiku (Drita Avdyli), apo filozofi (Përparim Kabo), gjuhë letërsi (Mimoza Ahmeti).

Ndërkohë edhe stafi akademik që lektron në vitin e dytë të studimeve 2017-2018 ka një background akademik në fushat kryesisht jo të lidhura me profilet e psikologjisë Organizative dhe psikologjisë Komunitare.

*Personeli akademik efektiv nuk ka kualfikim të vazhduar në profilin e psikologjisë së përgjithshme dhe as atë të profilizuar në fushën komunitare psikologjike apo atë të psikologut organizacional.*

Bazuar në dokumentin e dorëzuar dhe dosjeve të lektorëve, ata kryesisht janë kualifikuar në studime bachelori në, arte, muzikë (Inis Shkreli), shkenca politike (Arjeta Veshi), gjuhë - letërsi (Mimoza Ahmeti, Ilda Kashami, Skënder Demaliaj), sociologji (Mihal Zoto).

Diplomat Master të tyre janë kryesisht në profilet jo të lidhura drejtpërdrejtë me profilet Organizacionale apo Psikologji Komunitare dhe përkatësisht kemi master në marrëdhënie ndërkombëtare (Arjeta Veshi), media (Mihal Zoto), gazetari politike, Antropologji Kulturore (Inis Shkreli), ekonomike e juridike (Ilda Kashami), administrim (Mimoza Ahmeti).

Doktoraturat e tyre janë në fushat e Popullatë, Familje e Territor (Arjeta Veshi), marrëdhënie ndërkombëtare (Ilda Kashami) apo qeverisje e medias (Mihal Zoto), shkenca psikoterapeutike (Mimoza Ahmeti), që nuk kanë lidhje të profilizuar me programin e masterit shkencor me profile Psikologji Komunitare dhe Psikologji Organizacionale.

Klodjana Rafti staf akademik efektiv që ka ndjekur një vijimësi studimore në degët e psikologjisë dhe sociologjisë.

☑ **Të dhënat sipas seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit**

Personeli akademik efektiv(PAE) paraqitet me këto të dhëna:
**(Tabela nr 6/1 tek Anekset).**

Me moshën 25-35 vjeç është përkatësisht 1 person me gradën Doktor.
**(Tabela nr 6/2 tek Anekset).**

Me moshë 36-45 janë 2 persona me gradën Doktor;
Me moshë 46-55 janë 2 persona me gradën Doktor njëri dhe Profesor i Asociuar tjetri;
Me moshë 56-65 janë 3 me gradën Doktor dhe 1 me titullin Profesor i Asociuar;
Me moshë 66-68 vjeç 1 person me gradën Doktor.

Personeli akademik me kontratë (PAK) paraqitet me këto të dhëna:
**(Tabela nr 6/1).**

Me moshë 36-45 është 1 person me gradën Doktor;
Me moshë 66-68 është 1 person me gradën Doktor;

☑ **Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Gjatë vizitës në institucion u konstatua se kontratat e punës për personelin efektiv janë lidhur në mënyrë korrekte dhe në to janë të paraqitura të gjitha zërat e nevojshëm nga zyra e Burimeve Njerëzore. Kontrata tip për personelin efektiv paraqitet në dy gjuhë, shqip e anglisht. Përmban zërat e detyrat e punëmarrësit, afati i kontratës e koha e provës, vendi i punës, koha e pagës, shpërblimi, koha shtesë e punës, pushimet, lejet, çështje etike, konfidencialiteti, shëndeti e siguria në punë, detyrimet e punëdhënësit, konflikti i interesit, masat disiplinore, zgjidhja e kontratës së punës, dorëzimi i dokumenteve me zgjidhjen e kontratës së punës, korrespondenca, dispozita të përgjithshme.

Ndërkohë edhe kontrata e punës për personelin mësimor me kontratë përmban detyrimet dhe të drejtat e punëmarrësit e punëdhënësit, dhe specifikimet ligjore të nevojshme.

☑ **Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë**

Personeli ndihmës administrativ për vitin 2016-2017 është i përbërë prej 7 personash, ndërkohë që për vitin 2017-2018 janë 8 persona që mbulojnë asistencën e sekretariatit dhe atë teknike higjenosanitare.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. | Sipas bisedës me dekanin e fakultetit të shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, përgjegjësve të departamenteve të Psikologjisë e Sociologjisë, takimit me GVB, takimit me personelin akademik të UMSH, dhe shqyrtimit të DVV mund të thuhet se personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor angazohet vazhdimisht për të ndjekur procedura të caktuara.<br>Zyra e burimeve Njerëzore në bashkëpunim me departamentet përkatëse ndjek politikat e nevojshme për të rekrutuar staf të nevojshëm për të përmbushur nevojat e mësimdhënies dhe mbulimit me orë të programeve të caktuara. Kryesisht i gjithë personeli akademik është angazuar për të realizuar plotësisht programin mësimor në bazë të kurrikulës së miratuar dhe licensuar. Tërësia e produktit universitar është në përputhje me strategjinë e UMSH për të rritur efikasitetin dhe profesionalizmin në mësimdhënie për t'u zhvilluar edhe më. *Stafi akademik është kryesisht me grada shkencore Doktor dhe disa kanë edhe titullin Profesor i Asociuar, edhe pse vijimësia e studimeve të tyre nuk është e specializuar kryesisht në shkencat Psikologjike, për të justifikuar cilësinë në mësimdhënie dhe profilizimmin për masterin që po akreditohet,* por në ato Sociologjike, e Filozofike, Politike. Personeli akademik është me grada shkencore, me edukim bachelor dhe Master shkencor. |
| **Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. | Nga raporti i vlerësimit të brendshëm dhe nga biseda me dekanin e fakultetit dhe përgjegjësin e departamentit mësohet se për hartimin e kurrikulave të studimit të ciklit të dytë janë ngritur grupe pune sipas profileve. Përgatitja kërkimore shkencore e departamentit dhe lektorëve të përfshirë është synuar të jetë në përputhje me të njëjtën linjë të specialitetit. Kjo mund të thuhet përgjithësisht për profilin Psikologji komunitare, edhe pse asnjëri prej tyre nuk ka Master specific në Psikologji Komunitare dhe për profiling Psikologji organizacionale nuk ka asnjë të specializuar.<br>Kryesisht programi i studimit "Master i |

| | |
|---|---|
| | Shkencave" është hartuar në mbeshtetje të politikave kërkimore të institucionit. Të gjithë pedagogët janë munduar të sjellin eksperiencat e fushave të tyre studimore për të plotësuar mësimdhënien, këto eksperienca janë shumë konglomerate (nga psikoterapia, te Marrëdhëniet Ndërkombëtare, te Qeverisja e Medias, te Popullata, Familja e Territori).<br>Në këtë cikël mësimdhënia promovohet nga lektorë me gradë shkencore "Doktor" ose me titujt akademikë të kategorisë "Profesori i Asocuar".<br>Institucioni angazhon personel akademik dhe ndihmës për zhvillimin e programeve të studimit, në përputhje të plotë me standardet ligjore dhe zhvillimin institucional. Përsa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore ajo konsiderohet një proces i rëndësishëm që realizohet duke kombinuar kryesisht karakteristika themelore të pedagogëve:<br>• gradën shkencore;<br>• eksperiencën e punës pedagogjike<br>• kombinimin e moshave të ndryshme per ruajtjen e vazhdimësisë.<br>Përcaktimi i ngarkesës mësimore të pedagogëve realizohet në përputhje me standardet e ligjit në fuqi dhe me aktet nënligjore të rregullores së institucionit.<br>Në kontratat e punës së personelit akademik përcakohen qartësisht ngarkesa mësimore, ajo shkencore, administrative dhe këshillimore e çdo pedagogu të brendshëm e të jashtëm. Tejkalimi i saj paguhet nga institucioni, që garanton përgjithësisht një balancim harmonik të ngarkesës mes mësimdhënies dhe detyrimeve të tejra administrative e shkencore të stafit akademik me qëllim që secila të kryhet me cilësi dhe në kohën e duhur. |
| **Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; | Nga takimi me zyrën e Burimeve Njerëzore, si dhe shqyrtimi i dokumentit të statutit të Institucionit e rregullores së UMSH, mësohet se Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore përcakton para fillimit të çdo viti akademik kërkesat për personel akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, bazuar në nevojat për realizimin e programit mësimor. Kërkesa për rekrutimin e stafit akademik, pasi miratohet nga Dekani dhe Rektori, publikohet on-line në faqen zyrtare të "Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë", në median elektronike dhe atë të shkruar. Për të realizuar |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. | procedurën e përzgjedhjes, Rektori ngre një komision të kryesuar nga Dekani i fakultetit përkatës, i cili bën vlerësimin paraprak të kërkesave të paraqitura nga kandidatët. Kanditati parqet kërkesën dhe dokumentacionin perkatës pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. ZBNJ i përcjell Komisionit të ngritur nga Rektori dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët. Pas intervistës hartohet raporti nga ana e Komisionit, i cili ia dërgon në formë propozimi për miratim Rektorit. Zgjedhja e stafit të brendshëm kryehet në bazë të kritereve të parashikuara në statutin e UMSH dhe rregulloren e tij dhe nënshkruhet kontrata.<br>Personeli akademik efektiv (PAE) në vitin aktual përbën rreth **83% të personelit** akademik të angazhuar në realizimin e programit të tij (10 pedagogë nga 12 pedagogë gjithsej).<br>Institucioni në praktikën e tij ndjekj performancën, arritjet dhe mangësitë e mësimdhënies duke i testur ato vazhdimisht. Këto hapa janë të përcaktuar edhe në rregulloren e Institucionit dhe statutin e tij dhe aspektet kryesore të vlerësimit janë:<br>Procesi i mësimdhënies, veprimtaria shkencore brenda dhe jashtë institucionit,veprimtari të tjera në shërbim të institucionit, puna me studentët në veprimtari të tjera jashtëkurrikulare, ndërtimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me subjekte homologe, kontributi në përhapjen e përvojave inovative,respektimi i afateve për kualifikimin shkencor të marrjes së titujve e gradave shkencore,etj.<br>Miratimi për çdo pedagog efektiv apo me kontratë bëhet një dokument kryesor shkresor që përmban:<br>Deklarimin e personit,<br>Vlerësimin e Përgjegjësit të departamentit;<br>Vlerësimin e Dekanit të fakultetit;<br>Vlerësimin e ZBNJ<br>Vlerësimin e administratorit.<br>Institucioni përmban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, njoftimeve për punë, që është i aksesueshëm në faqen e UMSH.<br>Rekrutimi realizohet në mënyrë të hapur, transparente si për kandidatët ashtu edhe për institucionin. Vlerësohet dosja me dokumente por edhe intervista me personin e interesuar. |
| **Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon** | |

| | |
|---|---|
| **nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.** | |
| **Kriteri 1** Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;<br><br>**Kriteri 2** Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br><br>**Kriteri 3** Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;<br><br>**Kriteri 4** Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;<br><br>**Kriteri 5** Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. | Nga takimet me Zyrën e Burimeve Njerëzore në Universitet, nga kontrollet e kontratave dhe dosjet e pedagogëve, shqyrtimi i kurikulumeve të pedagogëve efektiv dhe atyre me kontratë, mësohet se përgjegjësi i departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë mban të fituar gradën shkencore PhD në Filologji, Universiteti "Babes-Bolyai", Fakulteti i Studimeve Europiane, Departamenti Etnologji-Antropologji, Cluj-Napoc, Rumani (2015). Nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me fushat e sociologjisë dhe psikologjisë por vetëm të tërthortë, por për gradën e përmbush kriterin.<br>Në programin e studimit Msc në Psikologji me profile 10 titullarë lëndësh kanë gradën shkencore 'Doktor' dhe 2 titullarë mbajnë titullin 'Profesor i asociuar".<br>Figurat drejtuese të universitetit, si rektori, zëvendës rektori, drejtori dhe zëvendës drejtori i qendrës universitare, dekani e zëvendës dekani, përgjegjësi i departamentit janë të punësuar me kohë të plotë në institucion.<br>Departamenti ka siguruar edhe orë për të udhëhequr studentët në praktika mësimore si dhe këto orë janë në ngarkesën e tyre mësimore të vitit akademik. |
| **Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.** | |
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;<br><br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br><br>**Kriteri 3** Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. | Nga takimet me pedagogët efektivë të programit, me përgjegjësin e departamentit dhe me studentët e programit mësohet se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me dy profile ndiqen për punën e tyre kërkimore dhe tezën e diplomës nga 5 pedagogë me kohë të plotë.<br><br>Këta 5 pedagogë gëzojnë të gjithë titullin 'Doktor'.<br>Aktualisht raporti udhëheqës teme/ student i nivelit master i shkencës është përafersisht **1 pedagog me 2 studentë.** |
| **Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.<br><br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. | Nga takimet me personelin mësimor efektiv dhe me studentët e përgjegjësin e departamentit, u theksua se udhëheqësit e temave janë në përputhje me kuadrin e specilizimit të tyre dhe me fushat specifike të psikologjisë apo edhe për tema me karakter të përgjithshëm social.<br>Pedagogët udhëheqës janë kryesisht ekspertë të çështjeve dhe kanë një punë kërkimore në temat që udhëheqin. |
| **Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore; | Nga takimet me studentët e programit dhe nga RVB mësohet se studentëve iu vihet në dispozicion laboratori i Informatikës dhe sistemi audio-viziv në çdo sallë ku zhvillohen leksione dhe seminare |
| **Kriteri 2** Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | Për realizimin e programit mësimor, është angazhuar në mënyrën me optimale personeli akademik dhe personeli ndihmës. |
| **Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;<br><br>**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore. | Nga takimet e realizuara me përgjegjësin e departamentit dhe me pedagogët efektivë që japin mësim në këtë master shkencor, si dhe bazuar te RVB faqe 30, përcaktimi i ngarkesës mësimore bazohet ne aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesat mësimore gjenden të pasqyruara edhe në miratimin e planit mësimor për çdo vit akademik me pedagogeët përkatës për çdo lëndë, mbështetur në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 20 dhe Nenit 7 të Rregullores për Programin e Studimit.<br>Gjithashtu, edhe ngarkesa mësimore dhe organizimi e drejtimi i tyre për programin e ciklit të dytë të studimit, vlerësohet me orë mësimore. |
| **Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. | Nga takimet me përgjegjësin e departamentit, Zyrën e Burimeve Njerëzore, takimet me sekretarinë e universitetit, nga shqyrtimi i regjistrave, dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, institucioni ka bazën e të dhënave për personelin akademik dhe mbështetës dhe kjo gjendet në zyrën e burimeve njerëzore, Sekretarinë Mësimore dhe ne njësinë bazë dhe atë qendrore.<br>Nga ana tjetër, edhe Departamenti, çdo fillim viti akademik disponon listën e plotë të personelit akademik dhe atij ndihmës që do të angazhohet për secilin semestër të vitit akademik (sipas dokumentacionit të dorëzuar; dokumenti me titull: Lista e stafit akademik). |

| | |
|---|---|
| | Gjithashtu, edhe lista e personelit akademik dhe atij ndihmës të Universitetit Mesdhetar, gjendet e publikuar në faqen zyrtare on-line. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave ka në përbërje të tij pedagogë me titullin Prof. Asoc. Dr., dhe gradën Doktor. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Ajo që vihet re në përgjithësi në UMSH dhe sidomos edhe në departamentin e Psikologjisë dhe Sociologjisë është fakti se institucioni ka realizuar në mënyrë korrekte procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe atij mbështetës në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Universitetit Mesdhetar. Në Departamentin e Psikologjisë dhe Sociologjisë janë afruar mësimdhënës me përvojë si dhe individë që kanë mbaruar studimet e tyre në universitete europiane. Gjithsesi, duhet punuar edhe më për të arritur afatet e përcaktuara për kualifikimin e mëtejshëm shkencor të personelit, si vazhdimësia e marrjes së titujve dhe gradave shkencore si detyrë e gjithsecilit, e parashikuar edhe në kontratën e punës.

Në fund të vitit akademik, Departamenti dhe Dekanati raportojnë për realizimin e objektivave të kualifikimit shkencor që konsiderohet pjesë thelbësore e performancës.

Insitucioni ka në përbërje të tij staf akademik të kualifikuar sa i përket gradave e titujve. Numri i pedagogëve me grada shkencore është rritur në vijimësi sipas planeve të tyre të studimeve për titujt pauses sipas legjislacionit në fuqi.

*Pikë e dobët e kësaj rubrike mbetet vijimësia e kualifikimit të stafit që lektron në këtë master shkencor në një drejtim, stafi akademik përmban kualifikimin e masterit shkencor apo gradës Doktor, por duhet staf akademik më i profilizuar për profilin Psikolog Organizacional. Ndaj sugjerohet rishikimi i stafit akademik për këtë profil.*

**Standardet për këtë rubrikë janë plotësuar kryesisht.**

## 4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Nga leximi i raportit të vlerësimit të brendshëm dhe nga vizitat në institucion u vlerësua edhe gjendja infrastrukturore e universitetit UMSH. Ky universitet ka një godinë me një sipërfaqe prej 3860 m2, dhe mësimi shtrihet nga dita e hënë në të shtunë dhe në disa periudha oraresh nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 21 të darkës, për shkak se studentët mund të jenë të pamundur për të ardhur në fakultet se disa janë të punësuar diku ose edhe për shkak të numrit të studentëve dhe programeve të ndryshme e të shumta që institucioni ofron. Programi master i shkencave në Psikologji me profile zhvillonte mësimin pasdreke në orën 17-21 të darkës. Godina është lehtësisht e arritshme, pasi gjendet në unazën e kryeqytetit.

Nga vizita u vërejtën dhe u vlerësuan disa faktorë si: ndriçimi i konsiderueshëm në të gjitha mjediset si sallat, apo biblioteka, pajisja me ashensor e rampa për t'i mundësuar të gjithë studentëve lëvizjen e lehtësuar, ajo është e kompletuar me stil standard e modern, me hapësira të nevojshme për aktivitetin

akademik, nevojat parësore, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit, internet, projektorë dhe sisteme mbrojtjeje nga zjarri, shërbim, ndihme të shpejtë. Godina ishte e pajisur edhe me shkallë emergjence, të cilat ndodhen në mes të korridorit te njësisë së pozicionuar në katin e dytë. Të gjitha mjediset ku studentët e këtij masteri zhvillonin mësim përmbushnin nevojat dhe kriteret për zhvillimin e mësimit. Godina gjithashtu kishte sallë konferencash me 120 vende, bibliotekën me sipërfaqe 107 m2, magazina, arkivë, tualete, një bar bufe, recepsion, mjedise shërbimi, zyrë këshilli studentor, kabinete pedagogësh, salla leksionesh, salla më të vogla seminaresh, mjedise çlodhjeje etj. Mjedisi ishte me ndriçim të mjaftueshëm dhe i bollshëm për lëvizje.

Edhe sallat e zyrat e personelit akademik ishin të pajisura me kushte të mira pune.

Nga vizita në institucion dhe mjediset e vëzhguara u vu re se mjediset e bibliotekës dhe leximit ishin hapësira me një sipërfaqe deri në 90 $m^2$, me rafte për revista, libra, për fakultete dhe programe mësimore të dukshme dhe funksionale për studentët dhe personelin akademik. Sallat e leximit ishin të pajisura me poste leximi dhe studimi dhe ka kompjutera me shërbim interneti për punën kërkimore të studentëve. Salla e Bibliotekës dhe leximit ishte me ndriçim të mjaftueshëm dhe me sistem kondicionimi. Biblioteka e Universitetit ishte e pajisur me literaturë të fushave të ndryshme me mbi 4000 tituj librash dhe tekstesh universitare, revista shkencore si dhe materiale të tjera shkencore, të ndara sipas drejtimeve: Ekonomi; Financë, Kontabilitet, Banka, Makro-Mikro, Statistikë, Marketing, Biznes, Menaxhim, Turizëm; Psikologji, Letërsi, Fjalor, Anglisht, Pedagogji, Biznes, Organizim, Taksa, Transaksione, etj.

Në bibliotekë u vu re një raft me libra të Psikologjisë së përgjithshme, gjithsej 10 tituj librash hard copy. *Nevojitet pasurimi i bibliotekës fizike me libra të nevojshëm për këtë master shkencor studimi Psikologji Organizacionale dhe Komunitare*. Në bibliotekë nevojiten të jenë të dokumentuara edhe ciklet e leksioneve të pedagogëve përkatës. Ato nuk gjendeshin aty.

Biblioteka Online e Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë ka mbi 327,325 tituj librash.

Nga takimet me dekanin e fakultetit dhe me përgjegjësin e departamentit u mësua se abonimet në Bibliotekën online Questia (www.questia.com) për të treja Fakultetet kanë një literaturë prej më shumë se 10 milion tituj librash. Edhe zyrat e Arkivës e të Protokollit u vizituan dhe u vu re se ishin të pajisura në përputhje me standarded e funksionimit maksimal të saj, për të ruajtur arkivimin e dokumentacionit shkresor dhe atij elektronik. Sekretariati është i pozicionuar në hyrje të godinës dhe i përshtatshëm për të ofruar shërbim studentëve e pedagogëve. Ndërkohë që zyrat e tjera si ajo e Financës, këshillit studentor, Burimeve njerëzore, Njësia e sigurisë së cilësisë dhe kërkimit shkencor, ajo e marrëdhënieve me jashtë, IT, Këshillimit të Karrierës, funksionojnë me standarde përmbushëse. Shërbimi i internetit është i dhënë atyre vazhdimisht dhe i aksesueshëm në çdo kat studimi.

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

**☑ <u>Mjediset për programin e studimit (sipas RVB)</u>**

- Salla për leksione **6**
- Klasa për seminare **15**
- Salla për aktivitete promovuese **1**
- Laboratorë informatike **3**
- Salla interneti **1**
- Salla për bibliotekë **4**
- Mjedis për fotokopjime, librari etj **1**
- Zyrë informacioni për studentët **1**
- Nyje hidrosanitare **53**

☑ **Mjediset për stafin:**

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin **7**
- Zyra për sekretarinë mësimore **3**
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore **8**
- Zyra për personelin akademik **2**
- Zyra për Njësinë e SBC **1**
- Nyje hidrrosanitare për personelin akademik **5**

Të dhënat për infrastrukturën janë bazuar në RVB

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;<br><br>**Kriteri 2** Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;<br><br>**Kriteri 3** Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve që ofron;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj. | Nga vizita në universitet dhe mjediset e këtij universiteti mund të thuhet se ky institucion e ushtron aktivitetin e tij në një godinë moderne dhe funksionale. Dokumentacioni i nevojshëm i vënë në dispozicion vërteton godinën si pjesë e një pasurie të paluajtshme qe ka në përdorim (me qera) prej me shumë se 6 vjet, ku ushtron aktivitetin e vet. Vihet re investimi në kohë i vazhdueshëm për rritjen e aksesit me instrumente dhe mjete të nevojshme që do të rritin efektivitetin e godinës. Nga bisedat me Dekanin e universitetit synohet të investohet edhe më në vijimësi. Godina shërben edhe për të kryer mësimin Master i Shkencave në Psikologji me profile dhe përgjithësisht i plotëson kriteret dhe standardet për politikat mësimore. Godina mirëmbahet vazhdimisht me mbikqyrje dhe rikonstruksione.<br>Institucioni duke qenë se ka sallë konferencash ofron shërbime edhe për orgaizimin e tyre për rritjen akademike të stafit e studentëve.<br><br>**Kriteri 4** nuk aplikohet për këtë program studimi. |
| **Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;<br><br>**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br><br>**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br><br>**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;<br><br>**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. | Nga vizita në bibliotekën mësimore institucioni ka siguruar ndër vite një literaturë të pasur, në ndihmë te studentëve, pedagogëve dhe punonjësve kërkimore-shkencorë.<br>Biblioteka dhe salla e studimit ndodhen në katin përdhes të godinës së Universitetit dhe ka aksesueshmëri për studentët, pedagogët dhe kërkuesit shkencorë. Bazuar edhe në rregulloren e UMSH bibliotekës i kushtohet një rëndësi e veçantë, pasi ajo është një njësi mbështetëse që ofron shërbime ndihmëse për studentët dhe si e tillë duhet të mirëmbahet dhe pasurohet.<br>Nga takimi me dekanin dhe përgjegjësen e departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë u informuam se çdo fillim vit akademik ata i kërkojnë pedagogëve për të dhënë një listë tituj librash të vlefshëm për t'u pasur në bibliotekë dhe me interes për ta dhe për procesin mësimor të studentëve. Biblioteka kishte shumë tituj kryesisht ekonomikë dhe juridikë.<br>*U vunë re pak tituj librash në psikologji si libra të dhuruar dhe ato të blerë nga institucioni, rreth 10-20 tituj librash. U vu re një mungesë e librave të printuar ose hard copy për t'i ardhur në ndihmë studentëve të Msc në Psikologji me profile. Gjithashtu u vu re mungesë e materialeve të cikleve të leksioneve të pedagogëve në bibliotekë.*<br>Bibliotekës i janë vënë në dispozicion edhe dhurime librash nga OSBE, Banka Botërore, Kuvendi i Shqipërisë dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan.<br>Shërbimi i internetit gjendet edhe në sallën e biblotekës (edhe si WiFi) ku lehtësisht mund të lundrohet në faqet e librit elektronik.<br>Literatura bazë e secilës lëndë të programit te studimit përbëhet nga tekste në gjuhën shqipe. Biblioteka e UMSH porosit botime të rej në rrugë elektronike, nga *site-t* e njohura të tregtimit te botimeve. Prane bibliotekës janë në shërbim të pakufizuar për studentët dhe për pedagogët 4 adresa te bibliotekës on line QUESTIA.<br>Për blerjen e literaturës se specializuar në fushën e kërkimit shkencor, UMSH në bashkëpunim me përgjegjësin e programit çdo fillim vit akademik vlerëson listën e titujve të librave në shqip për t'ia shtuar bibliotekës sipas nevojës së departamenteve.<br>Orari i punës së Bibliotekës është i vendosur në katin e parë dhe ne hyrje te Bibliotekës dhe është në funksion të studentëve dhe pedagogëve. |
| **Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;<br><br>**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike. | UMSH ka një numër të konsiderueshëm auditoresh për leksione dhe seminare, klasa zyra e një sallë konferencash, si dhe mjedise të tejra të nevojshme për lundrimin në internet të studentëve në funksion të realizimit të programit të studimit Master i shkencave.<br><br>Sallat përgjithësisht janë të përshtatshme për të kryer procesin e nevojshëm mësimor me ndriçim dhe kondicionim të përshtatshëm, me tabela shpjeguese, me WIFI gjithë kohën e nevojshme si dhe me vidiorprojektor për mësimdhënie. Kryesisht sallat plotësojnë kërkesat e sigurisë sipas ligjit.<br><br>*Institucioni nuk ka laboratorë për procese specifike për lektrime të caktuara në këtë program studimi përveç sallave të leksioneve, seminareve dhe bibliotekës mësimore.* |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Në përfundim të kësaj rubrike, mund të themi se UMSH plotëson shumicën e standardeve të kërkuara, pasi vlerësohet të vendosë në dispozicion të studentëve të këtij programi infrastrukturën e nevojshme për të realizuar me sukses procesin mësimor dhe pjesërisht aspektin kërkimor shkencor të nevojshëm.

Vihen re këto pika të forta të këtyre standardeve: Çdo vit akademik synohet të pasurohet biblioteka me shumë tituj të nevojshëm librash specifikë e profesionalë që dalin në treg sipas nevojave të departamenteve; së dyti biblioteka ka libra të dhuruar në hard copy mjaftueshëm në fushat ekonomike, historike, kulturore dhe juridike; studentët kanë mundësi të aksesojnë bibliotekën në orare të përshtatshme për ta; abonimet e vazhdueshme në adresën e www.questia.com i japin një zhvillim të madh aksesit të studentëve për të pasur në dorë mundësi kërkimi e studimi; studentët kanë në dispozicion sallat e kompjuterave ku zhvillojnë leksionet përkatëse dhe kryejnë punën e tyre kërkimore shkencore; si dhe të gjitha mjediset mësimore janë pajisur me kërkesat dhe standartet e ligjit në fuqi.

**Standardet për këtë rubrikë janë plotësuar kryesisht.**

Sugjerohet të përmbushen: *mungesa e titujve të botimeve në gjuhën shqipe të literaturës që mund të shërbejë për studentët e programit master shkencor në Psikologji me profile si kopje fizike, është një numër mjaft modest titujsh për Deparamentin e Psikologjisë dhe Sociologjisë në përgjithësi, dhe në veçanti për Masterin shkencor ;*
*Së dyti mungesa e kopjeve të depozituara në bibliotekë ose departament të leksioneve ose cikleve të leksioneve që pedagogët japin në këtë master.*

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Referuar statutit dhe rregullores së këtij Institucioni, Bordi i administrimit është organi më i lartë Kolegjial Administrativ, që siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Kostoja për student referohet të jetë, nga dokumentacioni i vlerësuar dhe nga raporti i vlerësimit të brendshëm, 106 Lekë për student përgjatë vitit akademik 2016-2017 dhe 137 lekë për student përgjatë vitit akademik 2017-2018. (Referoju edhe tabelës nr 8 te anekset).
Financimi i këtij Universiteti sipas takime me dekanin dhe shefin e departamentit kryesisht bëhet nga studentët dhe nga projekte të ndryshme që institucioni merr pjesë si bashkëpunëtor ose lider. Menaxhimi dhe administrimi i UMSH pasqyrohet në pasqyrat financiare të tij. Ky institucion ofron shërbime duke u fokusuar në misionin e tij dhe mban kontabilitet të rregullt sipas ligjit në fuqi. Zyra e financës dhe Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Ajo ndjek në punën e saj të gjitha standardet kombëtare të kontabilitetit, bazuar edhe në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 31. Kontrolli dhe auditi i brendshëm në UMSH realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm (neni 32 i rregullores). Pasqyrat financiare auditohen edhe nga ekspertë të jashtëm që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht kryhen nga shoqëria Croëe Horëath AL shpk.

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ **Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (Tabela 8 te anekset):**

- Grantet për kërkim **1.599**
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit **237,208 (viti I), 293,645 (viti II)**
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) **9,513(viti I), 3,362(viti II)**

☑ **Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)**

Sipas dokumentacionit të prezantuar dhe dorëzuar nga Univesiteti Mesdhetar i Shqipërisë, dhe nga bisedat me përfaqësuesit e financës së institucionit, rezulton se totali i financimit në lekë për vitet akademike 2016-2017 për programin Master i Skencave në Psikologji me profile, të ketë qenë 254,137, ndërsa për vitin 2017-2018 të ketë qenë 288,522. Kostoja për student ka qenë 106 për vitin 2016-2017 dhe 137 për vitin 2017-2018 **(Tabela 8 tek anekset).**

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.** | |
| **Kriteri 1** Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br><br>**Kriteri 2** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br><br>**Kriteri 3** Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh. | Nga vizitat në institucion dhe nga takimet me përgjegjësin e departametit të Psikologjisë dhe Sociologjisë, si dhe takimet me përfaqësuesit e zyrës së burimeve njerëzore dhe zyrës së kërkimit shkencor, zyrës së njësisë së suigurisë së brendshme të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulës, rregullorja e institucionit dhe statuti i tij, u konstatua se intitucioni auditohet çdo vit nga një kompani e çerifikuar. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.<br>Gjithashtu institucioni kryen auditimin e |

| | |
|---|---|
| | brendshëm, i cili nis me raportimet që lidhen me situatën financiare dhe kontrollin e përdorimit të burimeve, duke përpunuar një program të miratuar nga Bordi i Administrimit. Bordi i administrimit ka detyra specifike dhe të mirëpërcaktuara në statutin e institucionit nga neni 24 deri në atë 29. Bazuar edhe në Raportin e vlerësimit të brendshëm në mënyrë periodike, Bordi kërkon raporte për realizimin e buxheteve të dhëna për ekzekutim nga kërkesat e nevojat e paraqitura. Në raportin e auditit paraqiten edhe tarifat e studentëve dhe mënyrën më efikase të përdorimit të tyre në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies për këtë cikël studimesh master. |
| **Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. | Nga takimet në institucion me përgjegjësin e departamentit dhe Dekanin, si dhe bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm u mor informacioni që, UMSH harton një raport financiar, në të cilin pasqyron të dhënat financiare për programet e ndryshme që ofron, duke parashikuar në të kostot e çdo mjedisi fiks si dhe kostot për stafin akademik për programin master i shkencave. Kryesisht të ardhurat për këtë master janë nga studentët dhe nga projekte të ndryshme që fiton Departamenti përkatës dhe kafeneja e institucionit. Duke qenë se insitucioni ka edhe të ardhura të tjera nga burime të ndryshme (grante, projekte, kafeneja, programe të tjera studimi, etj), vihet re se ka një qëndrueshmëri financiare për vazhdimësinë e këtij masteri. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë funksionon bazuar në Ligji Nr. 8788, "Për Organizatat Jo Fitimprurëse" dhe Ligji nr. 8789, "Për Regjistrimin e Organizatave Jo Fitimprurëse". Sipas Statutit të këtij institucioni është Bordi i Administrimit organi më i lartë Kolegjial Administrativ, i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të Institucionit. Financimi, menaxhimi dhe administrimi i UMSH pasqyrohet qartësisht në Pasqyrat Financiare të tij sipas Bordit.

Institucioni ofron shërbime dhe mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Institucioni siguron audit të brendshëm dhe të jashtëm. Situata financiare e UMSH për këtë program studimi sigurohet nga të ardhurat e studentëve dhe projekte të ndryshme të departamentit si palë bashkëpunuese ose lider.

**Standardet për këtë rubrikë janë plotësuar plotësisht.**

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Nga vizita në institucion dhe përkatësisht nga takimet me Dekanin dhe përgjegjësen e Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë, si dhe me drejtuesen e zyrës së njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulës në UMSH, si dhe nga raporti i vlerësimit të brendshëm, si dhe dokumentacioni i kërkuar në institucion, u vlerësua se UMSH si institucion i kushton vëmendje edhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, me qëllim që të sigurojë një veprimtari mësimdhënëse cilësore, të denjë dhe në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi, si dhe bazuar në Statut dhe akte të tjera të brendshme rregullatore. Njësia e sigurimit të brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme. Është një zyrë që përbëhet nga kryetarja dhe nga Dekani e anëtarë të departamenteve përkatëse sipas fakulteteve. Stafi i ri është përzgjedhur në dhjetor të 2017. Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me zyrën e Burimeve njerëzore. Çdo fundvit në zyrën e Burimeve Njerëzore stafi akademik efektiv plotëson formularin e vetëvlerësimit me zëra të ndryshëm për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor dhe këto pasqyrohen në analizën e punës së kësaj zyre për vit akademik. Vlerësimi i pedagogëve bëhet nga format e vetëvlerësimit, vlerësimit të studentëve dhe të komisionit të ngritur nga zyra e NJSBCZH. Kryetarja e kësaj zyre siguroi se standardet për cilësinë e institucionit hartohen në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Manuali i Sigurimit të Brendshëm është i miratuar nga Senati Akademik. Manuali përmban dhe përshkruan të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me mënyrën e vetëvlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe aspekte të menaxhimit të cilësisë në kuadër të Fakulteteve të UMSH. Kjo zyrë është gjithnjë në korrent dhe në lidhje me udhëzimet e reja që dalin vazhdimisht nga MAS për rirregullimin e sylabuse të lëndëve. Është një zyrë vazhdimisht në përpjekje për të rritur kontrollin e cilësisë dhe promovuar punën e saj në raport edhe me atë të institucionit.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Për anëtarët e njësisë NJSBCZHK referoju tabelës nr 9 tek Anekset.

☑ **Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:**

Bazuar në takimin me drejtuesen e NJSBC dhe raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit Master i shkencave në Psikologji me profile vërehet se anketimet kryhen 2 herë në vit për të gjitha lëndët që zhvillohen gjatë vitit akademik, përkatësisht në fundin e semestrave mësimore.

- **Sa studentë janë anketuar?**

Anketimi kryhet para sezoneve të rregullta të provimeve dhe në të marrin pjesë studentët prezent dhe dëshirojnë të plotësojnë anketën. Ky numër zakonisht nuk është më i vogël se 60% e studentëve aktivë për vitin akademik.

- **Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?**

Përpunimi i anketimeve realizohet nga NJSBCZHK, e cila përpunon rreth 25% të anketave të plotësuara të zgjedhura në mënyrë rastësore. Për lëndët, të cilat ndiqen nga rreth 30 studentë, përpunohen të gjitha anketat e plotësuara. Per rastet kur numri i anketave të plotësuara është më i vogël se 25%, anketa nuk merret në konsideratë për t'u përpunuar.

- **Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm?**

Për secilin nga proçeset akademike që vlerësohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre, NJSBCZHK raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBCZHK. Shpesh rekomandimet kanë qenë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës, dhe në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm.

☑ **Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Gjatë takimit me drejtuesen e kësaj zyre morëm informacionin se NJSBCZHK aktivitetin e saj e zhvillon sipas një plani kalendar të përvitshëm, ku ajo programon kontrollet e vazhdueshme, sektorët dhe proceset nëpër të cilat do të ndodhi kontrolli. Kjo zyrë informon edhe rektoratin, drejtuesit e departamenteve në fakultete dhe përmes tyre në mënyrë konfidenciale gjithë stafin e UMSH mbi rezultatet e kontrolleve të bëra, rezultati paraqitet personit akademik ose administrtiv me një zarf të mbyllur. Kjo zyrë synon përmes këtij procesi marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. U bëmë me dije edhe përmes zyrës së siguimit të cilësisë si edhe përmes takimeve me drejtuesit e universitetit e drejtuesen e departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë se një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UMSH.

☑ **Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti.**

Përgjegjësitë janë sipas strukturës hierarkike organizative të institucionit dhe ato planifikojnë, organizojnë dhe grantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të cilësisë.

Kjo njësi vlerëson vazhdimisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të Universitetit dhe harton raportet përkatese të vlerësimit te brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.

☑ **Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre.**

Nga takimet dhe njëkohësisht nga raporti i vlerësimit të brendshëm, si dhe nga format e vlerësimit TIP të vëna në dispozicion, u vlerësua se një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UMSH është pyetsori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe lektorët. Ndër problemet më kryesore të referuara kanë qenë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimit, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Gjithashtu nga RVB dhe nga biseda me drejtuesen e zyrës ndikim të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, marrja e

mendimit të këshillit studentor si edhe pyetësoret me frekuencë semestrale apo mbi një problem specifik, ku merret mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo lektor. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të proçesit të vlerësimit të performancës, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik.

☑ **Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Mësohet nga vizita se NJSBCZHK përgatit raportin vjetor të vetëvlerësimit. Raportet përdoren si burim për përmirësimin e vazhduesshëm të cilësisë. Në raport NJSBCZHK -ja udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raporti përmban sugjerime përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë. Raporti shpallet publikisht.
Propozimet e NJSBCZHK shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete.

☑ **Politikat e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme**

Gjithashtu, duke qenë se rezultatet e vlerësimit apo kontrolleve të ushtruara raportohen tek rektori, dhe se ato paraqiten si një analizë SWOT, gjatë vitit akademik 2017-2018 NJSBCZHK është marrë specifikisht me adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve nga vlerësimi i jashtëm Institucional i bërë gjatë vitit të kaluar.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.<br><br><u>Të tërthorta:</u><br>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;<br>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;<br>c. Pyetje konceptuale;<br>d. Intervista;<br>e. Etj. | UMSH përdor metodologji vlerësimi për aktivitetet me karakter kontrolli që organizohen nga NJSBCZHK, për secilin nga proçeset akademike që vlerësohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu, rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBCZHK.<br>Nga ana tjetër, institucioni kryen ne mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Rezultatet e tyre i vënë në dispozicion të drejtuesve te institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre. Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit |

| | |
|---|---|
| <u>Të drejtpërdrejta:</u><br>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);<br>b. Dëgjime në auditor;<br>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;<br>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;<br>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);<br>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;<br>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;<br>h. Etj. | të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve ne studimet e tyre në UMSH, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog, etj. Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:<br><br>***<u>Të tërthorta</u>***: si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; pyetje konceptuale; apo intervista.<br><br>***<u>Të drejtpërdrejta</u>***: si: dëgjime në auditor; vlerësimi me pikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; apo vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës. |
| **Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm. | Gjatë vizitës në takimin e bërë me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, si dhe me përgjegjësen e NJSBCZHK, mësohet se institucioni rregullisht publikon raportet e vlerësimit të vitit akademik për punën mësimdhënëse dhe kërkimin shkencor të stafit të tij akademik efektiv dhe të jashtëm. Rekomandimet e këtyre raporteve janë në përpjekje të vazhdueshme për t'i përfshirë në politikat e ardhshme të vazhdimësisë së UMSH. Këto publikohen në websitin e UMSH-së. |
| **Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë. | Nga takimet në institucion u konstatua se NJSBCZHK çdo vit përgatit raportin vjetor në bazë të informacioneve të grumbulluara nga formatet e vetëvlerësimit dhe të dhëna të tjera të grumbulluara nga vlerësimet e studentëve për pedagogët dhe cilësinë e mësimdhënies, dhe këtë raport e përdor për të bërë një analizë vjetore për ecurinë e programeve të studimit të ciklit të dytë. Përkatësisht në këtë cikël studimi janë 3 vite akademike që janë vlerësuar pedagogët, viti i parë i kaluar, ky aktual dhe viti i dytë aktual. Raporti përmban edhe sugjerime për përmirësime të vazhdueshme. Këto rekomandime i adresohen edhe rektorit dhe dekanit për t'i përfshirë dhe parashikuar në politikat institucionale për përmirësimin e ecurisë së ardhshme të cilësisë së mësimdhënies. Raporti shpallet publikisht në faqen e internetit. Insitucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e |

| | |
|---|---|
| | mëtejshëm të programeve të studimit. |
| **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;<br><br>**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;<br><br>**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar. | Sigurimi i cilësisë së brendshme realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e studentëve dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është akredituar institucionalisht në vitin 2012.<br><br>UMSH harton politikat përkatëse për të siguruar proceset akademike përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Senatin Akademik.<br>Përfshirja e mekanizmave të tillë si grupet e punës, format e kontrollit, organizimi i pyetësorëve me studentët aktualë dhe të diplomuarit e rrit mundësinë e vjeljes së informacionit nga shumë burime në vazhdimësi.<br>Zyra e NJSBCZHK vazhdimisht ndikon në ndërgjegjësimin e personelit dhe stafit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe studentët për standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Por këto bëhen të ditura edhe në çdo fillim viti akademik nga zyra e NJSBCZHK.<br>Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet pëmes veprimtarisë së strukturve drejtuese, aktivitetit të NJSBCZHK dhe reflektohet në format standard të UMSH-së. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Kjo rubrikë e raportit është e një rëndësie të veçantë për UMSH-në, pasi në të i kushtohet një kujdes i veçantë për secilin punonjës, akademik apo staf mbështetës, dhe ky i fundit ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga NJSBCZHK.
Pika të forta të kësaj rubrike vlerësohen të jenë: funksionimi efektiv i NJSBCZHK, drejtuesja me eksperience që kryeson zyrën, ndjekja me rigorozitet e të gjithë procedures së vlerësimit të cilësisë së brendshme duke përfshirë çdo aktor të mundshëm si studentët aktualë, ato të diplomuar, stafin akademik, vetëvlerësimin, përgjegjësit e departamenteve dhe dekanin, raporti me analizën orientuese për rritjen e cilësisë së mësimdhënies për rritjen e cilësisë në të ardhmen.

**Standardet për këtë rubrikë janë plotësuar plotësisht.**

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

## 7. Programi i studimit, organizimi i tij

**Pjesa përshkrimore**

> **Terma reference**: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi mësimor Master i Shkencave në Psikologji me dy profile: Psikologji organizative dhe Psikologji komunitare ofrohet në përputhje me sistemin e Bolonjës në ciklin e dytë. Ndërtimi i programit është bërë mbi bazën e moduleve, i vlerësuar sipas sitemit ECTS dhe evidentohet në syllabuset përkatëse. Jepet informacion për çdo lëndë në aspektin e strukturës dhe orëve të realizimit të tij, si dhe ndarja e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ **Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Programi mësimor Master i Shkencave në Psikologji me dy profile: është licencuar me Urdher Nr. 401, datë 22.07.2016 dhe ka nisur aktivizimin e tij në vitin akademik 2016 – 2017. Ky program studimi ka si objektiva pajisjen e studentëve me formim të thelluar në psikologji sipas profileve. Konkretisht synohet përvetësimi i njohurive në fushën e këshillimit psikologjik me orientimin organizativ dhe komunitar dhe pajisja me aftësi praktike për të zhvilluar kapacitetet klinike, këshillimore, të empatizmit me nevojat e individit dhe ato të etikës në psikologji. Synohet të promovohet zhvillimi i studentëve sipas procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.

☑ **Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS ka 25 orë mësimore punë të studentit

☑ **Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

Në planin mësimor është i përcaktuar viti dhe semestri që do të zhvillohet secila lëndë. Në planin mësimor janë detajuar orët e leksioneve, seminareve dhe krediteve ECTS sipas cdo forme të mësimdhënies.

☑ **Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:**

Lëndët vlerësohen me ECTS (kredite) sipas raportit, 1/25 (1 ECTS kredit është i barazvlefshëm me 25 orë pune mësimore dhe individuale të studentit). Përcaktimi i ECTS (krediteve) bëhet nga departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë dhe miratohet nga Dekani.

☑ **Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara**

Nuk ka patur ndryshime mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara.

☑ **Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës**

Plani mësimor mbulohet nga pedagogë të kualifikuar, nga të cilët dy prej tyre me gradën Prof. Asoc dhe 8 të tjerë me gradën Dr., por duhet të mbahet në konsideratë nevoja e vijimësisë së kualifikimit të stafit, pasi personeli akademik që lekton në këtë program studimi nuk ka vjimësi kualifikimi në degët specifike në profilet Psikologji Organizative ose atë Komunitare.

☑ **Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.**

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

☑ **Analizë e cilësisë së syllabuseve**

Syllabuset paraqiten të plota, por vlerësohet se disa prej tyre nuk kanë përputhshmëri me objektivat dhe qëllimin e programit të studimit. *Syllabuset duhet të rishikohen dhe rifreskohen në përputhje me natyrën e programit të studimit, pasi disa tema të syllabuseve janë specifikisht për master në psikologji klinike.* Në hyrje të çdo syllabusi jepet përshkrimi i përgjithshëm i lëndës, numri i krediteve për çdo lëndë, emri i pedagogut që zhvillon lëndën, si dhe ndarja e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit. Janë të përcaktuara detyrimet e studentit dhe forma e vlerësimit. Për vlerësimin e plotë të përmbajtjes së sylabus-eve konstatohet se mungon përmbajta e leksioneve në hardcopy dhe softcopy, si dhe disa nga titujt e literaturës së detyruar dhe ndihmëse, nuk gjenden në bliotekën e institucionit dhe nuk janë lehtësisht të aksesueshme për studentët.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);<br><br>**Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | Programi i studimit Master i shkencave në Psikologji me dy profile: Psikologji Organizative dhe Psikologji Komunitare është licencuar me Urdhër nr 401, dt. 22.07.2016 nga MASR.<br><br>Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë, që studenti të realizojë 60 kredite gjatë një viti akademik. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional; | Programi i studimit Master i shkencave në Psikologji me dy profile, aplikohet për studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor. Programi është ndërtuar për të dhënë mundësinë për thellimin e njohurive teorike dhe praktike në fushën e psikologjisë organizative dhe asaj komunitare. Në program aktualisht pranohen, përveç studentëve që |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;<br><br>**Kriteri 4** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;<br><br>**Kriteri 5** Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;<br><br>**Kriteri 6** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura"dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;<br><br>**Kriteri 7** Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | kanë përfunduar bachelor në psikologji, edhe studentët që kanë përfunduar bachelor në degë të tjera si mësuesi, Cikël i Ulët, Sociologji, Punë Sociale, Infermieri.<br><br>*Kjo politikë pranimi vjen ndesh me objektivat e programit të studimit, për të nxjerrë psikologë të formuar, të cilët në të ardhmen do të ushtrojnë profesionin si psikologë organizativ ose komunitarë.*<br><br>Në bazë të ligjit nr.40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", profesionin e psikologut mund ta ushtrojnë vetëm ata studentë që kanë përfunduar dy cikle (bachelor dhe master) në psikologji. Përfshirja në këtë program studimi e studentëve të cilët kanë përfunduar bachelor në një degë të ndryshme nga psikologjia, i penalizon ata në të ardhmen në aplikimin e njohurive të thelluara që marrin nga program studimi.<br>Për më tepër që ky program studimi duhet të synojë thellimin e njohurive teorike dhe praktike të fituara nga studenti gjatë bachelor-it.<br><br>*Si i tillë, ky program studimi është i përshtatshëm vetëm për studentët që kanë përfunduar bachelor në psikologji, dhe kjo duhet të reflektohet në politikat dhe rregulloren e pranimit në këtë program studimi.* |
| **Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;<br><br>**Kriteri 2** Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve. | Programi i studimit Master i shkencave në Psikologji me dy profile, ka si objektiva të tij pajisjen e studentëve me formim të thelluar në psikologji sipas profileve përkatëse. Synohet përvetësimi i njohurive në fushën e këshillimit psikologjik me orientimin organizativ dhe komunitar dhe pajisja me aftësi praktike për të zhvilluar kapacitetet klinike, këshillimore, të empatizmit me nevojat e individit dhe ato të etikës në psikologji.<br>Synohet të promovohet zhvillimi i studentëve sipas procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Metodat e vlerësimit bazohen në vlerësimin e vazhdueshëm.<br>Programi dhe kurrikula e studimeve të këtij masteri ka pika të forta për të theksuar vazhdimësinë e marrjes së njohurive të duhura për profilizimin në fushën organizacionale dhe atë komunitare me mjaft lëndë të profilit përkatës. Por nevojitet të bëhen edhe disa rekomandime të vlefshme për përmirësimin e kurrikulës. Të tilla janë:<br>Rekomandohet që lënda *"Teknika cilësore të kërkimit dhe analiza e komunikimit"* të ristrukturohet |

si lëndë dhe të emërtohet si *"Metoda të avancuara të kërkimit sasior dhe cilësor në psikologji"* dhe në përmbajtjen e saj të përfshihet edhe kërkimi sasior në fushë.

*Studenti organizacional dhe ai komunitar do të punojë me grupe sociale më shumë dhe jo me individë, ndaj aftësimi i tij në kërkimin shkencor grupal është i rëndësishëm të jepet. Ndaj nevojitet të shtohet absolutisht pjesë e lëndës së kërkimit shkencor ana e kërkimit sasior. Nëse kjo lëndë është bërë edhe në nivelin e Bachelor-it, mund të shtohet mbiemri 'të avacuara', pra "Metoda të avancuara të kërkimit shkencor cilësor dhe sasior në psikologji".*

*Rekomandohet edhe që lënda "Fjalori psikologjik ndërkombëtar" të ndryshohet si lëndë në përputhje me objektivat e programit të studimit ose të zëvendësohet me një lëndë tjetër më të dobishme për studentët e këtij masteri.*

*Rekomandohet që lënda "Psikologji klinike e avancuar dhe etikë këshillimi" të ndahet në dy lëndë të veçanta. Nuk mundet të qëndojnë të dyja së bashku. Lënda "Psikologji klinike e avancuar" nuk është një lëndë që i nevojitet një psikologu organizacional dhe as atij komunitar. Ajo mund të qëndrojë pa mbiemrin 'e avancuar' pra vetëm si Psikologji klinike, si dhe duhet të përshtatet në përmajtjen e saj për studentët e profileve që i ofrohet dhe jo për studentët e profilit klinik. Ndërkohë që lënda "Etikë profesionale" mund të qëndrojë si lëndë më vete.*

*Këto rekomandime janë sugjeruar edhe nga Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë me vendim nr 174, datë 07. 07. 2016 në kuadër të hapjes së këtij masteri shkencor.*

*Rekomandohet gjithashtu që në kurikulën e këtij programi të parashikohen edhe lëndë si "Motivacioni në punë" apo edhe "Lidershipi dhe psikologjia e tij", pasi do të plotësonin konsiderueshëm cilësisht dhe profesionalisht përgatitjen teorike dhe praktike të studentit.*

*Rekomandohet gjithashtu që lëndët si "Oratori dhe marrëdhënie me publikun" si dhe "Kultura pop, komunikimi dixhital dhe globalizimi" të rishikohen në përmbajtjen e tyre për t'iu përshtatur më mirë nevojave të një psikologu organizacional, që studenti të përfitojë konkretisht prej tyre në apilikimin e profilit të tij në tregun e punës.*

*Rekomandohet gjithashtu që lënda "Psikopatologjia e zhvillimit"të hiqet si lëndë nga kurrikula, pasi vlerësohet e panevojshme për profilet e këtij masteri. Në mënyrën si është ideuar dhe konkretisht në titujt e leksioneve të saj kjo lëndë është më tepër prezantim i lënës 'Neurobiologji e sjelljes' dhe nuk vlerësohet të jetë e dobishme për psikologun komunitar. Është një*

| | |
|---|---|
| | *lëndë e profilit klinik. Ajo mund të zëvendësohet me një lëndë tjetër më të nevojshme dhe të përshtatshme që të plotësojë nevojat e masterit me profil komunitar.*<br>*Rekomandohet gjithashtu që të rishihen përmbajtjet e lëndëve "Etniciteti dhe psikologjia e integrimit" dhe "Shteti, rendi publik dhe të drejtat e njeriut", pasi këto vlerësohet të jenë shumë të ngjashme me njëra tjetrën, duken si përsëritje e secilës, si dhe të përshtaten për nevojat e një psikologu komunitar dhe jo sociologu.*<br>*Sugjerohet gjithashtu edhe rishikimi në të gjitha lëndët e kurrikulës i terminologjisë në shqip të titujve të leksioneve, pasi rezulton shumë jo e përshtatur në shqip.*<br>*Sugjerohet gjithashtu edhe që lënda "Shteti ligjor, rendi publik dhe të drejtat e njeriut" të ofrohet nga një këndvështrim shumë më psikologjik dhe jo juridik e sociologjik sic është paraqitur në kurrikulën e dhënë të masterit, pasi si e tillë kjo lëndë nuk i shërben shumë studentëve të masterit me profil komunitar.*<br>*Sugjerohet rishikimi i literaturës për lëndët si "Psikologjia komunitare dhe planifikimi i ndërhyrjes", "Psikologji shëndeti", "Shteti ligjor, rendi publik dhe të drejtat e njeriut" etj, që të kenë lidhje me profilet e masterit të ofruar.* |
| **Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e tranferimit të krediteve e njohurive të fituaara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;<br><br>**Kriteri 3** Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. | Programi i studimit është ndërtuar sipas fushave të studimit të përcaktuara, në përputhje me strategjinë e përgjithsme të institucionit dhe përgjithësist në përputhje me kërkesat e tregut të punës.<br>Në aspektin e programit mësimor, i jepet rëndësi punës në auditor, si dhe punës së pavarur të studentit.<br>Programi është hartuar në përputhje me sistemin e Bolonjës dhe ndërtimi i tyre është bërë mbi bazën e moduleve, të vlerësuara sipas sistemit ECTS.<br>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacion dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.<br>*Duhet të ndryshohen politikat e pranimit të studentëve në këtë program studimi, duke specifikuar se ky program studimi është i vlefshëm vetëm për studentët që kanë përfunduar bachelor në psikologji, me qëllim që të jetë në përputhje edhe me legjislacionin shqiptar dhe direktivat e BE-së për profesionet e rregulluara.* |
| **Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor; | Programi i Studimit Master i Shkencave në Psikologji, me dy profile: Psikologji organizative dhe Psikologji komunitare është ndërtuar në mënyrë që t'i jepet rëndësi aftësimit profesional dhe kërkimit shkencor, nëpërmjet punës së pavarur dhe praktikës |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2** Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;<br><br>**Kriteri 3** Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 4** Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij. | profesionale.<br><br>Programi është në përputhje me profilin e institucionit dhe strategjinë e tij.<br><br>*Gjithsesi, nga vizita e realizuar konstatohet se organizimi i kërkimit shkencor dhe mënyra e kryerjes së praktikës profesionale duhet të përmirësohet më tej dhe në mënyrë të vazhdueshme.* |
| **Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj. | Nuk aplikohet për këtë program studimi |
| **Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:<br>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kometar a ndërkombëtar;<br>b. kërkesat e punëdhënësve;<br>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;<br>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | Institucioni ka kryer dhe paraqitur një studim tregu. Mendohet se kërkesat e tregut lokal dhe kombëtar të punës për profesionin e psikologut do të jenë në rritje. Qëllimi i këtij programi studimi është të formojë psikologë që do të punojnë në fushën organizacionale dhe atë komunitare. Të dy këto fusha të psikologjisë janë të reja. Në lidhje me psikologjinë organizative, aktualisht nuk mund të bëhet një analizë e plotë e tregut, pasi punësimi në këtë sektor është fare i panjohur në tregun vendas të punës, ndërsa në fushën e psikologjisë komunitare vihet re një rritje e vëmendjes ndaj këtij sektori, sidomos me ndryshimet e fundit ligjore dhe kthimin e vëmendjes tek shëndeti mendor në komunitet.<br><br>Mbetet për t'u theksuar *nevoja e ndryshimeve në rrregulloren e pranimit të studentëve, për të bërë të mundur që studentët të cilët përfundojnë këtë program studimi, të kenë mundësi për të qënë pjesë e tregut të punës.* |
| **Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. | Programet e studimit nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë të ndihmojnë vlerat kulturore. Ky program studimi vjen në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik e shoqëror në vend. |
| **Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur | Programi i studimeve Master i Shkencave në Psikologji me dy profile, realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 35 kredite europiane |

| | |
|---|---|
| në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike; | ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve.<br>Kohëzgjatja e tyre është 2 vite akademike. |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike. | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program |
| **Kriteri 3** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë). | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program |
| **Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;<br><br>**Kriteri 2** Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike. | Informacioni mbi programin ofrohet në mënyrë shkresore dhe jepet në momentin e regjistrimit. Përmbajtja e syllabuseve është e konsultueshme për studentët edhe në formë elektronike.<br><br>Konstatohet se mungojnë përmbajtjet e cikleve të leksioneve të cilat rekomandohet që të bëhen pjesë e programit dhe t'i vihen në dispozicion paraprakisht studentit në formë shkresore dhe elektronike. |
| **Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.** | |
| **Kriteri 1** Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;<br><br>**Kriteri 2** Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën. | Parashikohet plani i diplomimit nëpërmjet realizimit të 120 krediteve ECTS, nga të cilat 35 prej tyre për punën kërkimore dhe tezën përfundimtare, në një kohëzgjatje 2 vjeçare. |

**<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>**

**Vlerësohet se standardet e mësipërme plotësohen kryesisht.**

Programi i studimit plotëson krieteret ligjore në lidhje me poiltikat e formimit të studentëve.

Përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit është i ndërtuar në mënyrë të përshtatshme dhe brenda kritereve për arritjen e qëllimit të tij.

Vlerësohet se disa nga syllabuset duhet të rishikohen dhe rifreskohen në përputhje me natyrën e programit të studimit.

- *Rekomandohet përfshirja e cikleve të leksioneve në përmbajtjen e syllabus-eve dhe plotësimi i bibliotekës me titujt e nevojshëm të literaturës së detyruar dhe ndihmëse.*
- *Rekomandohet gjithashtu ndryshimi i rregullores se pranmit të studentëve me qëllim që të garantohet ushtrimi i rregullt i profesionit të psikologut pas përfundimit të studimeve, duke përfshirë në këtë program studimi vetëm studentët që kanë përfunduar bachelor-in në psikologji.*
- Rekomandime të lëna nga lincesimi mbështetur në **VKA nr. 174, datë 07.07.2016**:

- *Rekomandohet gjithashtu, që lënda "Teknika cilësore të kërkimit dhe analiza e komunikimit" të ristrukturohet si lëndë dhe të emërtohet si "Metoda të avancuara të kërkimit sasior dhe cilësor në psikologji" dhe në përmbajtjen e saj të përfshihet edhe kërkimi sasior në fushë.*
- *Rekomandohet që lënda "Fjalori psikologjik ndërkombëtar" të ndryshohet si lëndë në përputhje me objektivat e programit të studimit ose të zëvendësohet me një lëndë tjetër më të dobishme për studentët e këtij masteri.*
- *Rekomandohet që lënda "Psikologji klinike e avancuar dhe etikë këshillimi" të ndahet në dy lëndë të veçanta. Nuk mundet të qëndrojnë të dyja së bashku. Lënda "Psikologji klinike e avancuar" nuk është një lëndë që i nevojitet një psikologu organizacional dhe as atij komunitar. Ajo mund të qëndrojë pa mbiemrin 'e avancuar' pra vetëm si Psikologji klinike si dhe duhet të përshtatet në përmajtjen e saj për studentët e profileve që i ofrohet dhe jo për studentët e profilit klinik. Ndërkohë që lënda "Etikë profesionale" mund të qëndrojë si lëndë më vete.*

- *Rekomandohet gjithashtu që në kurikulën e programit të masterit me profil Psikolog Organizativ të parashikohen edhe lëndë si "Motivacioni në punë" apo edhe "Lidershipi dhe psikologjia e tij", pasi do të plotësonin konsiderueshëm cilësisht dhe profesionalisht përgatitjen teorike dhe praktike të studentit.*
- *Rekomandohet gjithashtu që lëndët si "Oratori dhe marrëdhënie me publikun" si dhe "Kultura pop, komunikimi dixhital dhe Globalizimi" të rishikohen në përmbajtjen e tyre për t'iu përshtatur më mirë nevojave të një psikologu organizacional që studenti të përfitojë konkretisht prej tyre në apilikimin e profilit të tij në tregun e punës.*
- *Rekomandohet gjithashtu që lënda "Psikopatologjia e zhvillimit"të hiqet si lëndë nga kurrikula, pasi vlerësohet e panevojshme për profilet e këtij masteri. Në mënyrën si është ideuar dhe konkretisht në titujt e leksioneve të saj kjo lëndë është më tepër prezantim i lëndës 'Neurobiologji e sjelljes' dhe nuk vlerësohet të jetë e dobishme për psikologun komunitar. Është një lëndë e profilit klinik. Ajo mund të zëvendësohet me një lëndë tjetër më të nevojshme dhe të përshtatshme që të plotësojë nevojat e masterit me profil komunitar.*
- *Rekomandohet gjithashtu që të rishihen përmbajtjet e lëndëve "Etniciteti dhe psikologjia e integrimit" dhe "Shteti, rendi publik dhe të drejtat e njeriut",këto vlerësohet të jenë shumë të ngjashme me njëra tjetrën, duken si përsëritje e secilës si dhe të përshtaten për nevojat e një psikologu komunitar dhe jo sociologu.*

*SUGJERIME:*

- *Sugjerohet gjithashtu edhe rishikimi në të gjitha lëndët e kurrikulës i terminologjisë në shqip të titujve të leksioneve pasi rezulton shumë jo e përshtatur në shqip.*
- *Sugjerohet gjithashtu edhe që lënda "Shteti ligjor, rendi publik dhe të drejtat e njeriut" të ofrohet nga një këndvështrim shumë më psikologjik dhe jo juridik e sociologjik sic është paraqitur në kurrikulën e dhënë të masterit, pasi si e tillë kjo lëndë nuk i shërben shumë studentëve të masterit me profil komunitar.*
- *Sugjerohet rishikimi i literaturës për lëndët si "Psikologjia komunitare dhe planifikimi i ndërhyrjes", "Psikologji shëndeti", "Shteti ligjor, rendi publik dhe të drejtat e njeriut" etj, që të kenë lidhje me profilet e masterit të ofruar.*

## 8. Mësimdhënia

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhenies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia realizohet sipas lëndëve të veçanta që përmban programi i studimit, kryesisht në formën e leksioneve dhe seminareve. Format e përdorura janë leksionet, seminaret, praktikat profesionale dhe orët e konsultimit. Leksionet synohen të jenë interaktive dhe të japin formim të plotë teorik të lëndës

për studentin, njohuri të cilat më pas kontrollohen nëpërmjet seminareve. Ngarkesa mësimore për pedagogë është përgjithësisht në përputhje me normat e lejuara. Kontrolli mësimor bazohet në seminaret, që zënë 10 % të vlerësimit të përgjithshëm, provimet e ndërmjetme ose detyrat e kursit, që zënë 20 – 30 % të vlerësimit të përgjitshëm dhe provimit përfundimtar, i cil zë pjesën më të madhe të vlerësimit, 60 -70 % të tij. Vlerësimi i brendshëm kryhet nëpërmjet përgjegjësit të Fakultetit të Psikologjisë dhe Sociologjisë dhe nga organet e tjera administrative të institucionit. Aktivizimi i studentëve kryeht kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes si dëgjues në aktivitete shkencore ose në përfshirjen e herë pas herëshme në punën kërkimore të pedagogëve.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ **Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet për këtë program studimi janë (sipas RVB)**

- Leksione **495** orë në auditor
- Seminare **240** orë në auditor
- Praktikë profesionale **375** orë në auditor
- Orë konsultime **60** orë në auditor

☑ **Format e kontrollit të njohurive**

Format e kontrollit të njohurive janë:
Pjesëmarrja dhe aktivizimi gjatë frekuentimit të lëndës - 10 %
Detyra e kursit – 20 deri në 30 %
Provimi përfundimtar – 60 deri në 70 %

☑ **Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Aktivizimi i studentëve kryeht kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes si dëgjues në aktivitete shkencore ose në përfshirjen e herë pas herëshme në punën kërkimore të pedagogëve.

## 9. Studentët

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve mbështet në legjislacionin në fuqi dhe në aktet rregullatore të institucionit. Përzgjedhja bëhet nga një komision i caktuar nga Dekani, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur. Numri i studentëve përcaktohet nga kërkesat dhe kapacitetet e e stafit akademik dhe infrastrukturës së institucionit. Kohëzgjatja mesatare e zgjatjes së studimeve është 4 semestra.

**Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

☑ **Procedurat e pranimit të studentëve**

Procedurat e panimit mbështeten mbi kontrollin dhe verfikimin e dokumentacionit të paraqitur mbi bazën e kërkesës. Përpara regjistrimit, studentit i jepet mundësia për tu njohur me infrastrukturën dhe kapacitetet akademike të institucionit. Nëse dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, kryhet regjistrimi dhe dosja personale arkivohet dhe dixhitalizohet.

☑ **Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Përgjatë dy viteve akademike që ka filluar ky program studimi, janë rregjistruar në master shkencor në Psikologji Komunitare 18 studentë, me notë mesatare 7.25, ndërsa në Psikologji Organizative janë rregjistruar 13 studentë me mesatare të përgjithshme ne hyrje 7.75. Nuk mund të vlerësohet cilësia në dalje, pasi ende nuk ka të diplomuar në këto programe.

☑ **Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Bazuar në shqyrtimin e dosjes së vetvlerësimit dhe vizitës në institucion numri i studentëve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

| **Të dhëna për studentët e programit Msc në Psikologji me profile** | | | |
|---|---|---|---|
| **Vitet** | **Programi / profili** | **Të regjistruar për herë të parë** | **Nota mesatare në hyrje** |
| **2016 - 2017** | Psikologji komunitare | 9 | 7.5 |
| | Psikologji organizative | 6 | 8.1 |
| **2017 - 2018** | Psikologji komunitare | 9 | 7 |
| | Psikologji organizative | 7 | 7.4 |
| **Totali** | **MSC Psikologji** | **31** | |

☑ **Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse).**

Nuk ka të diplomuar nga ky program studimi

☑ **Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Nuk ka studentë të transferuar në këtë program studimi

☑ **Të dhëna për punësimin e studentëve**

Nuk ka të diplomuar nga ky program studimi

☑ **Numri total të diplomuarve**

Nuk ka të diplomuar nga ky program studimi

☑ **Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

Nuk ka të diplomuar nga ky program studimi

☑ **Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

Nuk ka të diplomuar nga ky program studimi

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|

| | |
|---|---|
| **Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;<br><br>**Kriteri 2** Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;<br><br>**Kriteri 3** Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;<br><br>**Kriteri 4** Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;<br><br>**Kriteri 5** Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit. | Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi zotërojnë diplomën "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.<br>Pranimi në programin e studimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi<br><br>Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë merr vendim në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve ku kriteri kryesor është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian.<br><br>*Kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi duhet të plotësohen, duke specifikuar se me qëllim ushtrimin e profesionit të psikologut pas përfundimit të këtij programi, studentët duhet që të kenë përfunduar "Bachelor" vetëm në psikologji.* |
| **Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.** | |
| **Kriteri 1** Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;<br><br>**Kriteri 3** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. | Përgjithësisht studentëve i jepet informacioni i mjaftueshëm në lidhje me akreditimin e programeve të studimit. Studentët këshillohen në mënyrë të vazhdueshme dhe informohen rreth vlefshmërisë së programit të studimit dhe mundësive e punësimit në të ardhmen.<br>Pranë institucionit funksionon Zyra e Karrierës, por konstatohet se informacioni në lidhje me ndryshimet e reja ligjore në fushën e ushtrimit të profesionit të psikologut është i pamjaftueshëm dhe duhet të përmirësohet.<br>Me daljen e ligjit 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në RSH" ka ndryshuar thelbësisht mënyrë e ushtrimit të profesionit të psikologut, ndaj studentët duhet të jenë më të informuar në këtë drejtim. |
| **Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;<br><br>**Kriteri 3** Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. | Aktualisht nuk ka të diplomuar në këtë program studimi.<br><br>Konstatohet se institucioni mban të dhëna statistikore për numrin e studentëve të regjistruar dhe moblitetin e tyre. Sekretaria Mësimore administron të dhënat elektronke të ecurisë akademike të studentëve që nga pranimi në programin mësimor. |
| **Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj. | Aktualisht nuk ka të diplomuar në këtë program studimi. |
| **Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;<br><br>**Kriteri 2** Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;<br><br>**Kriteri 3** Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve. | Rezulton se studentët janë të informuar në mënyrë të detajuar në lidhje programin e studimit, afatin dhe mënyrën e organizimi, si dhe statusin e akreditimit të tij.<br>Studentët informohen si për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit. Rezultatet e vlerësimit janë elektronikisht të aksesueshme dhe studentëve u jepet mundësia e diskutimit të vlerësimit. |
| **Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë. | Pranë institucionit funksionon Zyra e Karrierës, e cila ofron këshillim dhe mbështetje për studentët.<br>*Institucioni, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit siguron pjesërisht kryerjen e praktikës mësimore për studentët e tij.*<br><br>Vlerësohet se janë të nevojshme vendosjet e marrëdhënieve të tjera me institucione të ndryshme për realizimin e praktikës mësimore në psikologjinë organizative. |
| <u>**Konkluzionet e vlerësimit:**</u><br><br>**Institucioni plotëson standardet e mësipërme plotësisht.**<br><br>Forma dhe organizimi i mësimdhënies është e përshtatshme për këtë program studimi dhe në | |

përputhje me qëllimin dhe objektivat e tij. Format e vlerësimit gjykohen të përshtatshme dhe ndarja e mënyrës së vlerësimit nëpërmjet pjesëmarrjes në auditor, detyrave të kursit dhe vlerësimit përfundimar është në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shpërndarja e krediteve sipas orëve brenda dhe jashtë auditorit është e drejtë. Zyra e këshillimit funksionon në mënyrë aktive dhe ofron këshillime dhe mbështetje për studentët.

*Rekomandohet që në rregulloren e brendshme, kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi duhet të plotësohen, duke specifikuar se me qëllim ushtrimin e profesionit të psikologut pas përfundimit të këtij programi, studentët duhet që të kenë përfunduar "Bachelor" vetëm në psikologji.*

## 10. Kërkimi shkencor në funksion të programit
**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Politikat e kërkimit shkencor të Univeristetit Mesdhetar të Shqipërisë inkurajojnë pjesëmarrjen në kërkimin shkencor nëpërmjet evidentimit të rolit të tij dhe informimit të stafit akademik dhe studentëve për mundësinë e pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktualisht, puna kërkimore shkencore e studentit realizohet nëpërmjet përgatitjes së tezës finale, nën mbikqyrjen e pedagogut udhëheqës. Në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me dy profile: Psikologji organizative dhe Psikologji komunitare reflektohet rëndësia e kërkimit shkencor nëpërmjet rritjes së aftësive individuale të punës në grup. Rezulton që pjesëmarrja e stafit akademik në kërkimin shkencor, sidomos në fushën e botimeve, të ketë qënë e lartë. Raportohen rreth 1000 tituj botimesh nga stafi akademik. Ndërkohë që janë fituar tre projekte kërkimore, të cilat janë zbatuar plotësisht. Rezulton se institucioni ka organizuar disa aktivitete shkencore, madje raportohen 2 çmime kombëtare në këtë fushë. Kryesisht institucioni përpiqet të realizojë politikat e kërkimit shkencor brenda tij, me aktivitete të organizuara nga njësia ose të lidhur kryesisht me format e mësimdhënies, nëpërmjet punës së pavarur të studentëve nën drejtimin e pedagogëve.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ **Të dhëna për kërkimin shkencor**

Të dhënat për kërkimin shkencor pasqyrohen të raportuara nga institucioni dhe bazohen në botime, projekte kërkimore të realizuara dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore të organizuara nga vetë institucioni.

☑ **Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv TTAL**

Numri botimeve nga personeli akademik është 949 tituj

☑ **Numri i projekteve kërkimore të fituara**

Janë fituar 3 projekte kërkimore

☑ **Numri i projekteve të zbatuara**

Janë zbatuar 3 projekte kërkimore

☑ **Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL**

Janë organizuar nga institucioni 7 aktivitete shkencore

☑ **Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL**

Raportohet të kenë marrë pjesë në aktivitete 532 subjekte

☑ **Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor**

Në procesin mësimor numërohen 3 kërkime shkencore

☑ **Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor**

174 studentë janë përfshirë në kërkim shkencor

☑ **Numri i Çmimeve Kombëtare**

Raportohen 2 çmime kombëtare të fituara në fushën e kërkimit shkencor

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.** | |
